



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.164

23 tetor

2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 001 datë 6.10.2008	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”, të ndryshuar	8093
Ligj nr.10 002 datë 6.10.2008	Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme	8096
Ligj nr.10 003 datë 6.10.2008	Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar	8117
Ligj nr.10 004 datë 9.10.2008	Për ratifikimin e “Marrëveshjes kuadër të huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEDB) për financimin e projektit “Rehabilitimi i spitalit rajonal të Shkodrës – faza e tretë””	8119
Vendim i Kuvendit nr.219, datë 9.10.2008	Për zgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive	8135
Vendim i Kuvendit nr.220, datë 9.10.2008	Për mosmiratimin e dy anëtarëve të Komisionit të Konkurrencës	8135
Dekret nr.5914 datë 13.10.2008	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	8136

LIGJ
Nr.10 001, datë 6.10.2008

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.7908, DATË 5.4.1995 “PËR
PESHKIMIN DHE AKUAKULTURËN”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 14
Rregullimi i pragut të peshkimit

Numri maksimal i licencave të peshkimit detar përcaktohet nga ministria, sipas planit të administrimit të peshkimit.”.

Neni 2

Në nenin 15 bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Çdo mjet lundrues, që përdoret për peshkim profesional, pajiset me licencën përkatëse, e cila lëshohet nga ministri, pas miratimit nga bordi i peshkimit, në bazë të kërkesës për ushtrim veprimtarie.”.

b) Pika 2 shfuqizohet.

Neni 3

Neni 17 shfuqizohet.

Neni 4

Në nenin 23, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Peshkimi sportiv ushtrohet pa licencë.”.

Neni 5

Në nenin 25, fjalët “ose sportive” hiqen.

Neni 6

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 26

Cilido, që kërkon të fusë organizma ujorë të gjallë dhe vezë, larva ose rasate të specieve joendemike, në ujërat e Republikës së Shqipërisë, pajiset me leje ose autorizim mjedisor.”.

Neni 7

Neni 27 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 27

Veprimtaria e akuakulturës

1. Veprimtaria e akuakulturës zhvillohet nga subjektet fizike ose juridike, të cilat kanë objekt të veprimtarisë akuakulturën. Personat fizikë ose juridikë, të interesuar për zhvillimin e akuakulturës, tokësore dhe ujore, në pronat publike, u nënshtrohen procedurave të konkurrimit publik. Me fituesin, ministria ose përfaqësuesi i pronës shtetërore lidh kontratë qiraje. Procedurat për lidhjen e kontratës dhe ato të konkurrimit publik nuk zbatohen në rastet kur toka është në pronësi private.

2. Kontrata e qirasë lidhet vetëm kur zbatimi i projektit ndikon në zhvillimin e ekonomisë shqiptare dhe nuk shkakton efekte negative në mjedis. Personat fizikë ose juridikë, të interesuar për zhvillimin e veprimtarisë së akuakulturës, pajisen me leje ose autorizim mjedisor.

3. E drejta e përdorimit të tokave, në pronësi shtetërore, për zhvillimin e veprimtarisë së akuakulturës, përcaktohet në kontratë, pasi merret, për territorin në fjalë, edhe mendimi i organeve përkatëse.

4. E drejta e përdorimit të sipërfaqeve ujore të Republikës së Shqipërisë për zhvillimin e veprimtarisë së akuakulturës përcaktohet në kontratën e qirasë.

5. Sipërfaqet ujore të Republikës së Shqipërisë u jepen me qira personave juridikë e fizikë, për të ushtruar veprimtarinë e akuakulturës intensive, me synim shfrytëzimin e këtyre sipërfaqeve, në bazë të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm.

Procedurat dhe vlerat e qirasë, sipas kategorive ujore, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Në kontratën e qirasë, për rastet e përcaktuara në pikat 3 e 5 të këtij neni, jepen dhe kushtet e qirasë, përveç rasteve kur kjo është e parashikuar nga ligjet në fuqi. Vlerësimi i tokave shtetërore për qëllime të akuakulturës klasifikohet në një kategori me tokat bujqësore, sipas ligjeve në fuqi.”.

Neni 8

Neni 28 riformulohet si më poshtë:

“Neni 28

Kushtet e ushtrimit të veprimtarisë së akuakulturës

Në ushtrimin e veprimtarisë së akuakulturës, ministria mund të vendosë kushte për secilën nga pikat e mëposhtme:

- a) struktura, pajisjet dhe mirëmbajtja e impianteve;
- b) zonat ku do të zhvillohet veprimtaria;
- c) sasia dhe cilësia e ushqimeve që do të përdoren;
- ç) përdorimi i lëndëve kimike;
- d) mbajtja e regjistrave dhe paraqitja e informacioneve;
- dh) sinjalizimi i sëmundjeve që shfaqen;
- e) sasia, cilësia dhe llojet e të vegjëlve që mund të futen e përdoren;
- ë) shkarkimi i çfarëdo lloji materiali nga impiantet;
- f) kontrolli i cilësisë së ujit;
- g) transporti i peshkut;
- gj) domosdoshmëria e një licence të veçantë për veprimtaritë e lidhura me akuakulturën;

- h) kufizimi i zonës ku do të zhvillohet veprimtaria;
- i) sigurimet e detyrueshme.”.

Neni 9

Neni 29 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 29 Kohëzgjatja e kontratës

1. Kohëzgjatja e kontratave për sipërfaqet tokësore është deri në 20 vjet dhe për sipërfaqet ujore deri në 10 vjet. Pas mbarimit të afatit ato mund të rinovohen.
2. Në kontratë parashikohen afatet, brenda të cilave duhet të fillojnë e të përfundojnë veprat për ushtrimin e veprimtarisë. Në çdo rast, veprat duhet të përfundohen brenda tre vjetëve nga çasti i nënshkrimit të kontratës.”.

Neni 10

Titulli i kreut VII ndryshohet si më poshtë:

“KREU VII PESHKIMI NË LAGUNAT BREGDETARE DHE NË UJËRAT E BRENDSHME”.

Neni 11

Në nenin 31, pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Për ujërat e brendshme, e drejta e peshkimit fitohet nëpërmjet konkurrimit publik. Në ato kategori ujore, të shpallura si zona bashkëmenaxhimi, ku ekzistojnë organizatat e menaxhimit të peshkimit (OMP), kontrata lidhet me OMP-në, e cila pajis anëtarët e vet peshkatarë me dokumentacionin përkatës të anëtarësisë.”.

Neni 12

Në nenin 32, shkronjat “ë”, “f” e “j” ndryshohen si më poshtë:

- “ë) kushtet për lëshimin dhe rinovimin e licencave të peshkimit profesional;
- f) krijimin dhe mbajtjen pranë ministrisë të arkivit të licencave të peshkimit;
- j) peshkimin sportiv e, në veçanti, llojet, pajisjet, zonat, periudhat, ushtrimin e kësaj veprimtarie në ujërat e brendshme, përdorimin e mjeteve lundruese, kushtet për përdorimin e pushkës nënujore.”.

Neni 13

Në nenin 39 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- a) Pika 14 ndryshohet si më poshtë:
“14. Cilido, që zhvillon veprimtari peshkimi sportiv, me përdorim të një mjeti lundrues, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 23 të këtij ligji dënohet me gjobë nga 5 mijë deri në 10 mijë lekë.”.
- b) Në pikën 16, fjalët “ose sportiv” hiqen.
- c) Pika 17 ndryshohet si më poshtë:
“17. Cilido, që zhvillon veprimtari akuakulture në kundërshtim me nenin 27 të këtij ligji dënohet me gjobë:
 - i) 50 mijë lekë, nëse kapacitetet prodhuese janë deri në 30 tonë peshk;
 - ii) 100 mijë lekë, nëse kapacitetet prodhuese janë deri në 50 tonë peshk;
 - iii) 500 mijë lekë, nëse kapacitetet prodhuese janë mbi 50 tonë peshk.”.
- ç) Në pikën 18, fjalët “sipas nenit 23” zëvendësohen me fjalët “sipas nenit 19”.
- d) Pika 19 shfuqizohet.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5915, datë 22.10.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 002, datë 6.10.2008

PËR SHËRBIMIN E KONTROLLIT TË BRENDSHËM NË MINISTRINË E BRENDSHME

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton misionin, organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme, në vijim SHKB.

Neni 2
Misioni

Misioni i këtij shërbimi është t'i garantojë komunitetit një shërbim policor të përgjegjshëm, demokratik dhe transparent, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara.

Neni 3
Objekti i veprimtarisë

Objekt i veprimtarisë së SHKB-së janë:

a) parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi paraprak i veprave penale, të kryera nga punonjësit e Policisë së Shtetit, pavarësisht nga funksioni dhe grada, për vepra penale të konsumuara gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj;

b) inspektimi i punës së të gjitha strukturave të Policisë së Shtetit për përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara, për garantimin e përgjegjshmërisë, efektshmërisë dhe efikasitetit të tyre.

Neni 4
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Personel me kohë të pjesshme dhe me kontratë” janë punonjësit, me njohuri në fusha të posaçme, profesionet e të cilëve nuk janë të përfshira në tabelën e funksioneve të SHKB-së ose që zëvendësojnë persona që mungojnë, përkohësisht, për shkaqe të ligjshme.
2. “Shtetasit” janë shtetasit shqiptarë, shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi.
3. “Masat e përshkallëzuara” janë masa disiplinore, që jepen nga më e lehta deri te më e rënda, duke pasur gjithmonë parasysh pasojën e ardhur, rrethanat, lehtësuese dhe rënduese, ku është kryer shkelja, si dhe rrethanat e tjera, për personalitetin dhe rezultatet në punë.
4. “Testi i integritetit” është çdo lloj teknike apo metode që shërben për verifikimin e etikës dhe integritetin e një punonjësi të policisë.

Neni 5

Etika

Punonjësit e SHKB-së zbatojnë kodin e etikës së policisë dhe rregullat e etikës në administratën publike.

Neni 6

Respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut

Punonjësit e këtij shërbimi, në përmbushje të detyrave të tyre, respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të garantuara me ligj, si dhe kontribuojnë në realizimin e tyre.

Neni 7

Simbolet

SHKB-ja ka stemën dhe simbolet, të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 8

Dokumenti i identifikimit

1. Punonjësit e SHKB-së janë të pajisur me dokument identifikimi, që shërben si dëshmi dhe autorizim për të vepruar në emër të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, si punonjës të shërbimit. Punonjësi i SHKB-së mund ta marrë dokumentin e identifikimit, vetëm nëse ka përfunduar me sukses periudhën e trajnimit dhe të vlerësimit.

2. Forma, të dhënat dhe rregullat për përdorimin e dokumentit të identifikimit përcaktohen me urdhër të ministrit.

Neni 9

Statusi

1. SHKB-ja është një institucion i administratës publike dhe strukturë e veçantë e Ministrisë së Brendshme, në varësi të drejtpërdrejtë të ministrit.

2. SHKB-ja është e depolitizuar.

Neni 10

Buxheti

SHKB-ja ka buxhetin e vet, i cili është zë më vete në buxhetin e ministrisë. Drejtori i Përgjithshëm i SHKB-së është përgjegjës për menaxhimin efektiv dhe eficient të buxhetit të miratuar, i cili është objekt auditimi.

Neni 11

Fondi i posaçëm

1. SHKB-ja ka një fond të posaçëm që e përdor në funksion të veprimtarisë informative dhe procedurale penale. Fondi i posaçëm është një zë i veçantë i buxhetit të SHKB-së dhe nuk i nënshtrohet prokurimit publik.

2. Kushtet dhe kriteret për përdorimin dhe kontrollin e këtij fondi rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 12

Ministri

1. Ministri i Brendshëm është autoriteti përgjegjës për veprimtarinë e SHKB-së. Në përgjegjësitë e ministrit nuk përfshihet drejtimi operacional i SHKB-së.

2. Ministri:

a) përcakton objektivat strategjike vjetore, në përputhje me politikat shtetërore;

b) siguron bashkërendimin e punës së SHKB-së me Policinë e Shtetit dhe me strukturat e tjera të Ministrisë së Brendshme, si dhe bashkëpunimin me shërbimet e tjera informative, institucionet shtetërore e homologe të vendeve të tjera, në bazë të marrëveshjeve konkrete;

c) nxjerr urdhra dhe udhëzime për organizimin dhe funksionimin e SHKB-së, në përputhje me këtë ligj dhe me ligje të tjera në fuqi;

ç) përcakton procedurat për mbrojtjen e të dhënave dhe të burimeve të tyre nga ekspozimi i paautorizuar, si dhe metodat e punës;

d) përcakton procedura të veçanta, për klasifikimin dhe deklasifikimin e të dhënave të SHKB-së, që përbëjnë sekret shtetëror;

dh) përcakton procedurat për verifikimin e figurës së pastërtisë së punonjësve të Policisë së Shtetit dhe të Ministrisë së Brendshme, për të cilët kërkohet të pajisen me certifikatë sigurie;

e) kërkon raporte, informacione dhe dokumente të tjera, që lidhen me detyrat e SHKB-së.

3. SHKB-ja nuk i jep ministrit informacione, që mundësojnë identifikimin e dëshmitarëve, të bashkëpunëtorëve të drejtësisë ose informatorëve, si dhe informacione, për të cilat prokurori ka urdhëruar me shkrim që të këshillohen vetëm me persona të caktuar.

PJESA E DYTË

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONET

Neni 13

Organizimi dhe struktura e përgjithshme e SHKB-së

1. Struktura e këtij shërbimi është unike dhe drejtohet nga drejtori i përgjithshëm.

2. Shërbimi organizohet në departamente dhe drejtori, në nivel qendror dhe drejtori e sektorë, në nivel vendor.

3. Struktura dhe organika e drejtorisë së përgjithshme dhe strukturat vendore të SHKB-së miratohen nga ministri, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm.

Neni 14

Drejtori i Përgjithshëm i SHKB-së

1. Drejtori i Përgjithshëm i SHKB-së, në vijim drejtori i SHKB-së, emërohet, lirohet dhe largohet nga ministri.

2. Drejtori i SHKB-së është autoriteti më i lartë administrativ, teknik dhe operacional i këtij shërbimi.

Neni 15

Kriteret për emërimin e drejtorit të SHKB-së

Drejtor i SHKB-së emërohet personi që përmbush këto kriteret:

- a) të ketë shërbyer për një periudhë jo më pak se dhjetë vjet në strukturat e policisë, hetimit, shërbimeve informative ose me natyrë të ngjashme me to, nga të cilat, jo më pak se tre vjet në pozicione drejtuese;
- b) të ketë kryer studime, universitare, pasuniversitare, në specialitete që kanë të bëjnë me policinë, drejtësinë ose administratën publike;
- c) të mos ketë qenë i dënuar për veprë penale, me vendim të formës së prerë;
- ç) të mos jetë ndëshkuar për shkelje të rënda disiplinore, siç përcaktohen në rregulloren e disiplinës së SHKB-së, brenda dhjetë viteve të fundit, gjatë të cilave ka punuar në institucione shtetërore;
- d) të mos ketë konflikt interesi me detyrën.

Neni 16

Qëndrimi në detyrë i drejtorit të SHKB-së

1. Drejtori i SHKB-së emërohet për një periudhë kohe prej pesë vjetësh, me të drejtë riemërimi për një periudhë prej dy vjetësh.
2. Në rast se Drejtori i Përgjithshëm i SHKB-së plotëson shtatë vjet qëndrim në detyrë, ai caktohet në një detyrë tjetër, në përshtatje me arsimin dhe gradën që ka mbajtur para emërimit.

Neni 17

Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i SHKB-së

1. Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i SHKB-së, në vijim zëvendësdrejtori, emërohet, lirohet dhe largohet nga detyra nga ministri, me propozimin e drejtorit të SHKB-së.
2. Roli dhe funksionet e zëvendësdrejtorit përcaktohen në rregulloren e veçantë, të nxjerrë për këtë qëllim, të miratuar nga ministri.
3. Zëvendësdrejtori:
 - a) drejton dhe ushtron kontroll të drejtpërdrejtë për punonjësit e emëruar në departament;
 - b) zëvendëson drejtorin e SHKB-së, në mungesë të tij, sipas kompetencave të deleguara.

Neni 18

Kriteret për emërimin e zëvendësdrejtorit

Zëvendësdrejtor emërohet personi që përmbush këto kriteret:

- a) të ketë shërbyer për periudhën e nevojshme, në përputhje me nenin 69 të këtij ligji;
- b) të ketë kryer studime universitare ose pasuniversitare në fushën policore, të drejtësisë ose të administrimit;
- c) të mos ketë qenë i dënuar për veprë penale, me vendim të formës së prerë;
- ç) të mos jetë ndëshkuar për shkelje të rëndë disiplinore, siç përcaktohet në rregulloren e disiplinës së SHKB-së, brenda dhjetë viteve të fundit, gjatë të cilave ka punuar në institucione shtetërore;
- d) të mos ketë konflikt interesi me detyrën.

Neni 19

Lirimi dhe largimi nga detyra i drejtorit të SHKB-së dhe i zëvendësdrejtorit

1. Drejtori i SHKB-së ose zëvendësdrejtori lirohen nga detyra nga autoriteti që i ka emëruar, për njërën nga arsyt e mëposhtme:
 - a) është dënuar për një veprë penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - b) plotëson moshën për pension;
 - c) jep dorëheqjen;

- ç) nuk mund të ushtrojë funksionet për një periudhë kohore më të gjatë se 3 muaj.
d) i mbaron mandati.
2. Masat disiplinore për drejtorin dhe zëvendësdrejtorin e SHKB-së jepen nga ministri dhe janë:
- a) vërejtje me shkrim;
 - b) gjobë në masën sa paga përkatëse nga 5 deri në 15 ditë pune;
 - c) lirim nga detyra.
3. Masat disiplinore jepen për njëërën nga arsyet e mëposhtme:
- a) ka kryer shkelje të rëndë të disiplinës, në përputhje me rregulloren e disiplinës;
 - b) vlerësim negativ pune të dokumentuar, për shkelje të rregullave të integritetit, në përputhje me aktet nënligjore për disiplinën dhe personelin;
 - c) ka shfaqur mungesë të theksuar angazhimi në përmbushjen e objektivave strategjike dhe në kryerjen e detyrave të caktuara nga ministri, sipas nenit 12 të këtij ligji.

Neni 20

Personeli i SHKB-së

1. Personeli i SHKB-së ndahet në katër kategori:
- a) personeli hetues, që kryen veprime operacionale, përfshirë ndalimin dhe arrestimin, i cili ka kualifikimin dhe trajnimin e duhur policor dhe juridik;
 - b) personeli inspektues, me arsim të lartë, i përzgjedhur me konkurrim të hapur dhe që i nënshtrohet trajnimeve. Jo më pak se gjysma e numrit të përgjithshëm të këtyre punonjësve duhet të kenë mbaruar arsimin e lartë, dega juridik;
 - c) personeli mbështetës, i cili duhet të ketë arsimin dhe kualifikimin e duhur, sipas specifikës së punës që kryen;
 - ç) personeli me kohë të pjesshme dhe me kontratë.
2. Rregullat dhe procedurat për marrëdhëniet e punës, të trajnimit, ecures në karrierë dhe ndërprerjes së saj përcaktohen në rregulloren e personelit, të dalë në zbatim të këtij ligji, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

PJESA E TRETË KOMPETENCAT E SHKB-SË

KREU I KOMPETENCAT HETIMORE

Neni 21 **Kompetencat**

1. Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm ushtron kompetencat në përputhje me këtë ligj, me Kodin e Procedurës Penale dhe me aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi.
2. Në zbatim të detyrave, personeli hetues ka atributet e Policisë Gjyqësore.
3. Për rastet e kryerjes së operacioneve të fshehta, punonjës të caktuar të SHKB-së kanë të drejtë të përdorin identitete të rreme. Procedura për marrjen e këtij identiteti rregullohet me urdhër të drejtorit të SHKB-së.

Neni 22

Armatimi dhe përdorimi i forcës

1. Personeli hetues i SHKB-së ka të drejtë të mbajë armë. Llojet e armatimit dhe të mjeteve të tjera të përdorimit të forcës nga SHKB-ja përcaktohen me urdhër të ministrit.
2. Punonjësi e përdor armatimin dhe forcën në përputhje me nenet 118 e 119 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, ligjet përkatëse në fuqi dhe aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të tyre.

Neni 23
Mbledhja e të dhënave

1. Për përmbushjen e detyrës, punonjësit hetues të SHKB-së kanë të drejtë dhe përgjegjësi të mbledhin, të administrojnë dhe të ruajnë të dhëna për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprave penale, të kryera nga punonjësit e Policisë së Shtetit, pavarësisht nga detyra e grada, duke shfrytëzuar çdo burim të ligjshëm informacioni.

2. Drejtuesit e strukturave të Policisë së Shtetit dhe të Ministrisë së Brendshme, për zbatimin e këtij ligji, janë të detyruar të bashkëveprojnë me këtë shërbim.

3. Kur punonjësit e Policisë së Shtetit, të Ministrisë së Brendshme dhe të institucioneve të tjera shtetërore, për shkak të detyrës, vihen në dijeni për përfshirjen në vepra penale të punonjësve të Policisë së Shtetit, janë të detyruar ta njoftojnë menjëherë këtë shërbim.

4. Për të dhënat e marra për përfshirjen në vepra penale të punonjësve, që janë subjekte të punës së SHKB-së, shërbimet informative njoftojnë SHKB-në, brenda një afati të caktuar dhe sipas mënyrës së parashikuar në një udhëzim të përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe të drejtuesve të shërbimeve informative.

5. Autoritetet me kompetenca policore mund të bëjnë hetime dhe arrestime në flagrancë të punonjësve të policisë, por janë të detyruara të njoftojnë menjëherë SHKB-në.

6. SHKB-ja u kërkon punonjësve të Policisë së Shtetit deklarata për veprimtaritë e jashtme, dypunësimin, investimet, pasuritë dhe dhuratat ose privilegjet, nga të cilat mund të lindë një konflikt interesash, për shkak të funksioneve të tyre si nëpunës publikë.

7. Për mbledhjen e të dhënave, SHKB-ja mund të përdorë bashkëpunimin e fshehtë me individë, edhe kundrejt shpërblimit, vëzhgimin (mbikëqyrjen) e fshehtë të personave dhe të mjediseve.

8. SHKB-ja ka të drejtë të kontrollojë dhe të marrë dokumente, evidenca dhe informacione, në formë të shkruar ose elektronike, nga të gjitha zyrat, sekretaritë dhe arkivat e Policisë së Shtetit ose nga çfarëdo burim tjetër informacioni. Në rast se ka dyshime të bazuara se është kryer një vepër penale, sendet dhe dokumentet e përmendura më sipër sekuestrohen, nëse plotësohen kriteret e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

9. Organet e administratës publike, personat fizikë e juridikë janë të detyruar të paraqesin të dhënat identifikuese dhe informacionet e mbledhura në mënyrë të ligjshme, kur kërkohen nga shërbimi dhe që i përkasin objektit të veprimtarisë së tij, përjashtuar të dhënat, shpërndarja e të cilave është e ndaluar me ligj.

10. Personi, që ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me SHKB-në, është i detyruar të ruajë sekretin e këtij bashkëpunimi dhe të informacioneve të klasifikuara, derisa të përfundojë detyrimi ligjor për ruajtjen e këtij sekreti.

11. Rregullat konkrete për përdorimin e burimeve të informacionit, të përcaktuara në këtë nen, si dhe për marrjen, administrimin, verifikimin dhe vlerësimin e të dhënave, që përfitohen prej tyre, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Brendshëm.

Neni 24
Masa të veçanta për mbledhjen të dhënave

1. Kur në bazë të të dhënave, që disponohen, dyshohet se një person, subjekt i punës së SHKB-së, sipas këtij ligji, ka kryer një vepër penale ose po planifikon apo po organizon të kryejë një krim dhe kjo veprimtari nuk mund të zbulohet ose të parandalohet në rrugë e mënyra të tjera, punonjësi hetues i SHKB-së i bën kërkesë:

a) prokurorit për përgjimin e fshehtë të bisedave të këtij personi në vende publike, duke përdorur pajisje teknike për fotografim, filmim dhe regjistrim audio/video;

b) prokurorit për përdorimin e pajisjeve gjurmuese të vendndodhjes;

c) për përgjimin e telekomunikimeve të këtij personi, në përputhje me legjislacionin përkatës.

2. Për gjurmimin dhe hetimin e veprave penale, SHKB-ja ka të drejtë të përdorë teknika të posaçme hetimore, me lejen e prokurorit, sipas legjislacionit në fuqi, për të siguruar provat e fajësisë, përfshi edhe identifikimin, gjurmimin dhe sekuestrimin e produkteve të krimit.

3. Përdorimi i masave të veçanta, sipas pikës 1 të këtij neni, lejohet për aq kohë sa ekzistojnë

arsyet ose rrethanat, që kanë bërë të nevojshëm përdorimin e tyre dhe ky afat zgjatet, sipas afateve të vendosura në legjislacionin përkatës.

4. Kur brenda 6 muajve pas përfundimit të përdorimit të masave të veçanta, të parashikuara në këtë nen, nuk bëhet referimi i veprës penale prokurorit që ndjek çështjen, për të cilën janë përdorur masat e veçanta, i gjithë informacioni i mbledhur, si rezultat i përdorimit të këtyre masave, veçohet për asgjësim, me afat ruajtje 5 vjet.

5. Rregullat konkrete për procedurat e përgjimit, të përcaktuara në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni, si dhe për marrjen, administrimin, verifikimin dhe vlerësimin e të dhënave që përfitohen prej tyre, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe Prokurorit të Përgjithshëm.

6. SHKB-ja, në funksion të objektit të veprimtarisë së saj, ka të drejtë të kryejë testin e integritetit të punonjësve të Policisë së Shtetit. Rregullat dhe procedurat për kryerjen e këtij testi përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 25

Veprimtaria informative

1. Veprimtaria informative e SHKB-së, në kuptim të këtij ligji, vlerësohet procesi i grumbullimit, sistemimit, vlerësimit, analizimit, shpërndarjes dhe përdorimit të informacionit, për parandalimin e zbulimin e veprave penale, të kryera nga punonjësit e Policisë së Shtetit.

2. Veprimtaria informative e SHKB-së bazohet vetëm në të dhënat e marra dhe të administruara, në përputhje me ligjet përkatëse në fuqi dhe me aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të tyre.

3. Rregullat konkrete për realizimin e veprimtarisë informative të SHKB-së dhe masat për ruajtjen e të dhënave e për kontrollin e kësaj veprimtarie informative përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 26

Hetimi i shkeljeve

1. Nëse nga verifikimi për një shkelje disiplinore dyshohet se një punonjës i Policisë së Shtetit ka kryer një shkelje, që përbën vepër penale, të gjitha materialet e çështjes i dërgohen Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, i cili procedon me hetimin e çështjes, sipas Kodit të Procedurës Penale.

2. Nëse nga hetimi i çështjes nga SHKB-ja nuk rezulton se punonjësi i policisë ka kryer vepër penale, materialet, së bashku me një relacion shpjegues, i kthehen Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda dy ditëve pune nga marrja e këtij vendimi. Në këtë rast, Policia e Shtetit mund të vazhdojë me procedimin disiplinor.

Neni 27

Përpunimi i të dhënave personale

1. Mbledhja, ruajtja, përdorimi dhe komunikimi i të dhënave personale, për qëllime ligjore të SHKB-së, kufizohet vetëm me nevojat operacionale, kur janë të nevojshme për parandalimin e rrezikut real ose parandalimin e një vepre penale. Gjatë përpunimit të të dhënave respektohen parimet dhe rregullat e përcaktuara nga Këshilli i Europës në konventën “Për mbrojtjen e individëve për përpunimin automatik të të dhënave personale” e datës 28 janar 1981, ratifikuar me ligjin nr.9288, datë 7.10.2004 “Për ratifikimin e konventës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale””, me ligjin nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe me ligjin nr.8792, datë 10.10.2001 “Për krijimin e qendrës së përpunimit të të dhënave”.

2. Të dhënat mund t’u komunikohen agjencive të huaja homologe vetëm në bazë të një marrëveshjeje bashkëpunimi, sipas së cilës struktura, që i kërkon këto të dhëna, merr përsipër detyrimin e trajtimit e të ruajtjes së tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke siguruar një shkallë të caktuar të mbrojtjes së të dhënave, të barabartë ose në nivel më të lartë se ajo që garantohet në ligjet e mësipërme.

KOMPETENCAT INSPEKTUESE

Neni 28 **Inspektimi**

1. SHKB-ja, në përputhje me ligjin, ushtron inspektime.
2. Inspektimi nënkupton vlerësimin e mënyrës së kryerjes së detyrave në Policinë e Shtetit, duke siguruar arritjen e qëllimeve, në përputhje me legjislacionin dhe standardet e kërkuara.

Neni 29 **Llojet e inspektimeve**

SHKB-ja kryen dy lloj inspektimesh:

- a) “Inspektim të zakonshëm”, që nënkupton vlerësimin e efektshmërisë dhe të efikasitetit të strukturave të Policisë së Shtetit;
- b) “Inspektim të jashtëzakonshëm”, që nënkupton vlerësimin e strukturës apo të departamentit të Policisë së Shtetit, për shkak të krijimit të një situatë apo ngjarjeje të papritur.

Neni 30 **Urdhri për kryerjen e inspektimeve**

1. Drejtori i SHKB-së autorizon me shkrim kryerjen e inspektimeve të zakonshme dhe të jashtëzakonshme në Policinë e Shtetit.
2. Drejtori i SHKB-së mund të fillojë një inspektim të jashtëzakonshëm në Policinë e Shtetit vetë ose me urdhër të Ministrit të Brendshëm. Urdhri i ministrit shoqërohet me autorizim, i cili jepet me shkrim ose me gojë në raste urgjente. Në raste urgjente, kur autorizimi është dhënë me gojë, ministri duhet ta lëshojë atë me shkrim sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 48 orë nga dhënia e urdhrat.
3. Autorizimi me shkrim për të kryer inspektim të zakonshëm ka afat njëvjeçar dhe skadon në fund të vitit kalendarik.
4. Në autorizim duhet të jepen arsyeja dhe qëllimi i inspektimit.
5. Inspektimi i jashtëzakonshëm duhet të fillojë sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 3 ditë pune nga data e lëshimit të autorizimit.

Neni 31 **Inspektime të zakonshme**

1. Para fillimit të çdo viti kalendarik, drejtori i SHKB-së miraton planin e inspektimeve të zakonshme për çdo departament apo strukturë të Policisë së Shtetit. Për këto lloj inspektimesh nuk ka nevojë për autorizim të posaçëm.
2. Drejtori i SHKB-së miraton protokollet, që përdoren nga nëpunësit e inspektimit gjatë kryerjes së inspektimeve të zakonshme, sipas fushave të mëposhtme të përmbushjes së detyrave të Policisë së Shtetit:
 - a) menaxhimin e ndërtesave, të buxhetit, financave, prokurimeve, parkut të automjeteve dhe pajisjeve;
 - b) menaxhimin e burimeve njerëzore;
 - c) menaxhimin e armëve të zjarrit, të municionit, pajisjeve dhe armëve të tjera;
 - ç) menaxhimin e shoqërimit, të ndalimit dhe arrestimit;
 - d) menaxhimin e patrullave të trafikut dhe të sigurisë në rrugë;
 - dh) menaxhimin e zbulimit dhe të hetimit të krimit;
 - e) menaxhimin e ruajtjes dhe të kontrollit të kufirit e migracionit;
 - ë) menaxhimin e ankesave kundër policisë dhe hetimin e shkeljes disiplinore;
 - f) menaxhimin e planeve vendore të policimit, të sigurisë në komunitet dhe nismat e policimit në komunitet;
 - g) menaxhimin e përpunimit të të dhënave personale dhe pajtueshmërinë me ligjin në zbatim.
3. Ministri, nëse e sheh të arsyeshme dhe të nevojshme, mund të përfshijë në këtë listë edhe

fusha tjera të menaxhimit të Policisë së Shtetit.

Neni 32

Inspektime të jashtëzakonshme

Drejtori i SHKB-së miraton procedurat standarde të punës gjatë inspektimeve të jashtëzakonshme.

Neni 33

Mënyrat për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimeve

1. SHKB-ja, për mbledhjen e të dhënave në funksion të inspektimeve të zakonshme dhe të jashtëzakonshme:

- a) kryen kontrollin e gjendjes së ndërtesave, automjeteve dhe pajisjeve;
- b) kryen kontrollin e regjistrave dhe të dosjeve, qoftë me përmbledhje dokumentesh apo në mënyrë elektronike ose në formën e regjistrimeve audio/video;
- c) interviston të punësuarit dhe shtetasit;
- ç) interviston personat e shoqëruar dhe të arrestuar;
- d) përdor pyetësorët, që janë plotësuar nga të punësuarit ose shtetasit.

2. Punonjësit e inspektimit të SHKB-së, gjatë një inspektimi të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm, mund të marrin dokumente ose kopje të tyre, qofshin ato të shkruara apo elektronike dhe të regjistrimeve audio e video, nëse kjo është e nevojshme, për të hartuar raportet e inspektimit.

3. Punonjësit e inspektimit të SHKB-së zbatojnë të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të tyre, për ruajtjen e sekretit dhe të të dhënave.

4. Me marrjen e autorizimit me shkrim, titullari i strukturës, ku bëhet inspektimi, ndihmon me të gjitha mjediset e institucionit që drejton dhe udhëzon personelin të japë ndihmesë të plotë për punonjësit e inspektimit të SHKB-së.

5. Kur drejtuesi i strukturës, ku do të bëhet inspektimi, sjell pengesa, pa pasur një shkak të ligjshëm, punonjësit e inspektimit të SHKB-së i raportojnë drejtorit të SHKB-së, i cili vendos nëse çështja i dërgohet ministrit ose Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për marrjen e masave disiplinore.

6. Ministri nxjerr udhëzime për procedurat e kryerjes së inspektimeve.

PJESA E KATËRT STATUSI I PUNONJËSIT TË SHKB-SË

KREU I TË PËRGJITHSHME

Neni 34

Pranimi në SHKB

1. Ka të drejtë të konkurrojë, për t'u pranuar si punonjës i Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, çdo person, që plotëson kriteret e mëposhtme:

- a) është shtetas i Republikës së Shqipërisë;
- b) ka zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- c) përmbush kërkesat për nivelin arsimor, sipas vendit të punës;
- ç) është në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht, për të kryer detyrën;
- d) jep informacionin e kërkuar për punën e tij të mëparshme ose ndonjë çështje tjetër, që lidhet me pranimin e tij në shërbim;

dh) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për një vepër penale të kryer me dashje. Në rast se personi është dënuar për një vepër penale të kryer nga pakujdesia, duhet të vlerësohen pasojat dhe rrethanat e kryerjes.

2. Pranimi në SHKB bëhet me konkurrim të hapur, në bazë të vendeve të lira të punës. Shpallja e vendit të lirë të punës botohet në dy gazeta kombëtare me tirazh të madh. Pranimi kalon në

fazat e shqyrtimit dhe të verifikimit paraprak të dokumentacionit, të testimit me shkrim, të intervistës me gojë dhe të verifikimit të figurës.

3. Personat, që punësohen në Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, krahas kërkesave të përgjithshme, duhet të plotësojnë kushtet për t'u pajisur me certifikatë sigurie, për njohjen e informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror" dhe disa kërkesa për punë të veçantë.

4. Pranimi në shërbim mund të kryhet me urdhër të ministrit, pa konkurrim, në raste të veçanta dhe për profesione specifike, pas plotësimit të kërkesave të përcaktuara në pikat 1 e 3 të këtij neni. Në urdhër duhet të jepen edhe arsyet e pranimit pa konkurrim.

5. Marrja në punë dhe caktimi në detyrë i punonjësit të shërbimit bëhet nga drejtori i SHKB-së, sipas propozimeve të sjella nga njësia e personelit.

6. Personi, që pranohet në SHKB, nënshkruan, ditën e parë të punës, një kontratë, në përmbajtjen e së cilës ekzistojnë sanksione në rastet e refuzimit, për të shkuar në vendin ku është caktuar të shërbejë.

7. Kriteret e veçanta për pranimin në punë, përbërja e komisionit të testimit, procedura e zhvillimit të konkursit dhe rastet e zhvillimit të procedurave të pranimit, pa konkurrim, përcaktohen në rregulloren e personelit.

Neni 35

Trajnimi dhe kualifikimi

1. Kandidati, i cili përzgjidhet për t'u pranuar si punonjës i SHKB-së, duhet:

- a) të kryejë trajnimin përkatës, sipas vendit të punës;
- b) të vihet në periudhë prove për dy vjet nga data e emërimit.

2. Punonjësi, i punësuar në SHKB para hyrjes në fuqi të këtij ligji, që nuk ka kryer trajnimin përkatës në një institucion të shkollimit policor apo me natyrë të ngjashme, duhet ta kryejë atë brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e ligjit.

3. Kriteret për trajnimin e punonjësve të SHKB-së përcaktohen në rregulloren e personelit.

Neni 36

Shkollimi dhe kualifikimet jashtë shtetit

1. Njohja dhe ekuivalentimi i shkollimeve të kryera jashtë shtetit bëhen në përputhje me ligjin për arsimin e lartë.

2. Njohja dhe ekuivalentimi i trajnimeve policore të kryera jashtë shtetit bëhen me urdhër të Ministrit të Brendshëm.

3. Një person, i emëruar në SHKB, në përputhje me dispozitat e këtij neni, duhet të kryejë trajnim për legjislacionin shqiptar.

Neni 37

Periudha e provës

1. Punonjësi, që punësohet në Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, i nënshtrohet një periudhe prove, që zgjat 2 vjet nga data e emërimit. Gjatë kësaj periudhe ai është nën kujdesin e një punonjësi me stazh në punë dhe vlerësohet nga eprori më i afërt i tij. Kërkesat për kryerjen e detyrës gjatë periudhës së provës përcaktohen nga drejtori.

2. Në fund të periudhës së provës, me propozimin e eprorit direkt, drejtori i SHKB-së vendos:

a) konfirmimin si punonjës i SHKB-së, kur personi vlerësohet i aftë për të marrë përsipër realizimin e detyrës;

b) lirin si punonjës i SHKB-së, kur personi vlerësohet i paaftë për të marrë përsipër e për të realizuar detyrën. Paaftësia duhet të konfirmohet nga njësia që ka kryer kontrollin dhe inspektimin e punës së këtij personi.

3. Vlerësimi i punës për punonjësit në periudhë prove bëhet një herë në gjashtë muaj. Vlerësimi përfundimtar bëhet në përfundim të periudhës së provës.

Neni 38

Caktimi i detyrave dhe transferimi i punonjësve

1. Personit të emëruar në SHKB i caktohen detyra, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
2. Personi i emëruar në SHKB, në përputhje me gradën që ka, mund të caktohet me shërbim kudo, brenda territorit të vendit.
3. Transferimi bëhet gjithmonë për pozicione, të cilat janë brenda drejtimit të punës së tyre dhe me kusht që, në këtë rast, pozicionet të kërkojnë të njëjtën gradë.

Neni 39

Vlerësimi i punës

1. Vlerësimi i rezultateve individuale të punës së punonjësit të SHKB-së bëhet një herë në vit, si dhe në rastet e përfundimit të periudhës së provës, transferimit dhe përjashtimit nga ky shërbim.
2. Procedurat dhe kriteret e vlerësimit të punës përcaktohen në rregulloren e personelit.

Neni 40

Komandimi

1. Punonjësi i SHKB-së, për nevoja pune, mund të komandohet, me urdhër të drejtorit të SHKB-së, për një periudhë jo më tepër se gjashtë muaj ose deri në përfundimin e çështjes.
2. Gjatë kohës së komandimit, punonjësit i ruhet vendi i punës, ku merr edhe pagën.
3. Në rastet e komandimit jashtë vendbanimit, punonjësi i komanduar përfiton dietë, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 41

Lirimi dhe përjashtimi nga SHKB-ja

1. Një punonjës i SHKB-së lirohet ose përjashtohet nga ky shërbim, në përputhje me kushtet e këtij neni dhe kur është dhënë autorizimi i nevojshëm, sikurse përcaktohet në pikën 4 të po këtij neni.
2. Një punonjës i SHKB-së lirohet nëse:
 - a) deklarohet i paaftë nga ana shëndetësore, me vendim të komisionit mjeko-ligjor;
 - b) i shkurtohet funksioni organik dhe nuk mund të sistemohet në një funksion tjetër për të njëjtën gradë brenda këtij shërbimi, si dhe nuk pranon uljen në gradë, kur ka mundësi sistemimi;
 - c) punësohet në struktura të tjera të administratës publike;
 - ç) mbush moshën për pension të plotë pleqërie;
 - d) mbush moshën për pension të parakohshëm dhe kërkon të largohet nga ky shërbim;
 - dh) vlerësohet i paaftë për realizimin e detyrës së ngarkuar, të paktën pas dy vlerësimeve të njëpasnjëshme të rezultateve në punë;
 - e) kërkon vetë të lirohet.
3. Një punonjës i SHKB-së largohet nga puna nëse dënohet me burgim, me vendim gjyqësor të formës së prerë, për një vepër penale të kryer me dashje, shkel detyrimet e përcaktuara në nenin 46 të këtij ligji, si dhe kur ndaj tij merret masa disiplinore e përjashtimit nga SHKB-ja. Në rast se personi është dënuar për një vepër penale të kryer nga pakujdesia, vlerësohen pasojat dhe rrethanat e kryerjes së veprës.
4. Lirimi dhe përjashtimi i punonjësit të SHKB-së bëhen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të SHKB-së.

Neni 42

Ripranimi në SHKB

Një punonjës i SHKB-së, i liruar sipas shkronjës “b” të pikës 2 të nenit 41 të këtij ligji, mund të ripranohet në SHKB kur krijohen vende të lira në pozicionin për të cilin ai ka kualifikimin e duhur. Nëse ripranimi bëhet brenda 12 muajve të pandërprerë, ai rifiton gradën e mëparshme. Nëse ripranimi bëhet në një periudhë nga 12 muaj deri në 36 muaj pas liritimit, punonjësi ka të drejtë të ripranohet në një pozicion, që i përgjigjet gradës, që vjen menjëherë më poshtë asaj, që ai mbante çastin e liritimit.

Nëse personi kërkon të ripranohet pas 36 muajve nga data e lirimit, ai duhet t'i nënshtrohet procesit të konkurrimit për pranim në SHKB nga fillimi.

KREU II DETYRIMET KRYESORE TË PUNONJËSVE TË SHKB-SË

Neni 43

Detyrat e përgjithshme

Punonjësi i Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm ka për detyrë:

- a) të njohë dhe të veprojë në përputhje me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi;
- b) të veprojë me profesionalizëm, paanshmëri dhe në përputhje me kodin e etikës;
- c) t'i trajtojë personat në mënyrë të barabartë dhe t'i kryejë detyrat pa diskriminim, në përputhje me ligjin dhe standardet e kërkuara;
- ç) të respektojë dinjitetin dhe integritetin fizik të çdo punonjësi tjetër të shërbimit;
- d) të zbatojë urdhrat e bazuar në ligj;
- dh) të njoftojë eprorin se heq dorë nga kryerja e detyrës, për shkak të konfliktit të interesit.

Neni 44

Detyrimi për të zbatuar urdhra të bazuar në ligj

1. Çdo punonjës i SHKB-së duhet të zbatojë të gjithë urdhrat e ligjshëm, që i jepen nga një person më i lartë në funksion ose në gradë.
2. Kur një punonjës i SHKB-së ka shkaqe të mjaftueshme të dyshojë se urdhri i dhënë nga eprori i tij është i paligjshëm, ai duhet, pa vonesë, t'ia bëjë të ditur eprorit dhe të kërkojë që urdhri të jepet me shkrim.
3. Punonjësi epror i SHKB-së ka detyrimin të japë urdhrin me shkrim, nëse i kërkohej, sipas pikës 2 të këtij neni.
4. Në rastet kur moszbatimi i urdhrin deri në dhënien me shkrim të tij, sipas pikës 3 të këtij neni, rrezikon jetën e një personi tjetër, punonjësi i SHKB-së duhet të zbatojë urdhrin.
5. Kur një punonjës i SHKB-së, edhe pas zbatimit të procedurave, sipas pikave 2 e 3 të këtij neni, vazhdon të ketë arsye për të dyshuar se urdhri është i paligjshëm, ai:
 - a) kundërshton urdhrin, me përjashtim të rastit të parashikuar në pikën 4 të këtij neni;
 - b) vë menjëherë në dijeni titullarin, i cili është drejtpërdrejt mbi eprorin që ka dhënë urdhrin, të cilit i njofton edhe masat e marra prej tij, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Neni 45

Detyrime gjatë ushtrimit të kompetencave policore

Punonjësi i SHKB-së, gjatë ushtrimit të kompetencave policore, duhet:

- a) të marrë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar arratisjen e një personi, në rastet e shoqërimit, të ndalimit apo të arrestimit;
- b) të kërkojë ndihmë mjekësore dhe të marrë masat e nevojshme, realisht të zbatueshme, për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e personit të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar, për të cilin ka shkaqe të arsyeshme për kujdes mjekësor;
- c) t'i vijë në ndihmë një punonjësi tjetër të SHKB-së gjatë ushtrimit të detyrës, kur ka shkaqe të arsyeshme për ndihmë, e cila është më parësore se kryerja e detyrës, me përjashtim të rasteve kur kjo ndihmë refuzohet;
- ç) të përdorë shenjat dhe simbolet e miratuara për SHKB-në vetëm gjatë kryerjes së detyrës.

Neni 46

Depolitizimi

1. Punonjësi i SHKB-së nuk duhet të manifestojë sjellje dhe të mbajë qëndrime, që cenojnë natyrën e depolitizuar të institucionit. Ai nuk mund të mbështesë fushatën e një partie, të një organizate politike, të një anëtarit të një partie politike apo të një kandidati të pavarur, duke marrë pjesë ose kontribuar fizikisht apo financiarisht. Atij i ndalohet anëtarësimi dhe pjesëmarrja në veprimtaritë e partive apo të shoqatave politike, si dhe të bëjë propagandë në favor ose kundër partive, shoqatave politike apo kundër kandidatëve në zgjedhje.

2. Punonjësi i SHKB-së ka për detyrë të ushtrojë funksionet në mënyrë të paanshme dhe pavarësisht bindjeve politike.

3. Ndalohet punësimi në bazë të përkatësive dhe bindjeve politike.

Neni 47

Kufizimi i së drejtës së grevës

Punonjësi i Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm nuk ka të drejtën e grevës.

Neni 48

Detyrimi për të mos dhënë informacione të klasifikuara dhe përjashtimi nga publikimi

1. Punonjësi i SHKB-së nuk duhet të japë informacione të klasifikuara në asnjë lloj rrethane.

2. Pika 1 e këtij neni përbën detyrim për zbatim edhe për punonjësit e SHKB-së të liruar ose të përjashtuar nga ky shërbim.

3. SHKB-ja përjashtohet nga detyrimi për publikimin e dokumenteve dhe të të dhënave të klasifikuara “Sekret shtetëror”.

Neni 49

Detyrimi për të raportuar ankesat dhe shkeljet

Punonjësi i SHKB-së i raporton eprorit përkatës ose, në mungesë të tij, eprorit të eprorit çdo ankesë për sjelljen e një punonjësi të SHKB-së apo shkelje nga ana e tij.

Neni 50

Kufizimi për veprimtari të dyta

1. Punonjësi i SHKB-së nuk mund të punësohet ose të kryejë veprimtari private, të cilat pengojnë plotësimin e kërkesave të detyrës.

2. Në rastet e dypunësimit, punonjësi i SHKB-së merr miratimin me shkrim të drejtorit.

3. Punonjësi i SHKB-së ka detyrimin të njoftojë, paraprakisht, drejtorin nëse ndërmerr një veprimtari apo drejton një biznes, që mund ta çojë në konflikt interesi me kompetencat dhe detyrën e tij.

KREU III

TË DREJTAT E PERSONELIT

Neni 51

E drejta e pagës dhe e shpërblimit

1. Për shkak të natyrës së veçantë të punës, punonjësi i SHKB-së ka përparësi në trajtimin me pagë.

2. Paga e punonjësit të SHKB-së me kompetenca hetimore caktohet sipas gradës dhe funksionit që punonjësi ka fituar. Paga mujore e tyre përbëhet nga paga bazë, që është paga për gradë dhe nga shtesat mbi pagën bazë (në përqindje ose në shumë absolute) për kushte dhe natyrë të veçantë të vendit të punës e të shërbimit, përfshirë profesionin, kualifikimin dhe kohën e qëndrimit në gradë, për kompensim të privacioneve e humbjeve, që i shkaktohen atij, për shkak të punës e të shërbimit.

3. Paga e punonjësit inspektues dhe mbështetës të SHKB-së njehsohet me pagën e punonjësve të tjerë të administratës publike, duke marrë parasysh edhe natyrën e veçantë të punës.

4. Punonjësi i SHKB-së përfiton të gjitha shtesat e tjera të veçanta mbi pagë, që përfitojnë punonjësit e tjerë të administratës publike.

5. Punonjësit e SHKB-së përfitojnë çdo vit, në fund të vitit financiar, një shpërblim deri në një pagë mujore, të njëjtë me atë të përfituar nga punonjësit civilë dhe punonjësit e tjerë të administratës shtetërore. Ky shpërblim jepet në bazë të një shkalle përpjesëtueshmërie, që pasqyron kohën e punës së kryer nga punonjësi gjatë vitit financiar. Punonjësit, që nuk mungojnë në punë, për çfarëdo arsye, përveç kohës së pushimit, kanë të drejtën e shpërblimit të plotë. Kjo pagë nuk përfitohet në rastet kur punonjësi është ndëshkuar me masën e përjashtimit.

6. Rregullimi i pagës, shpërblimit dhe ndihmës ekonomike, kriteret dhe përgjegjësitë për dhënien e tyre miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 52

Koha e punës dhe e pushimit

1. Koha e punës dhe e pushimit për punonjësit e SHKB-së njësohet me atë të punonjësve të tjerë të administratës publike, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

2. Pushimi vjetor i pagueshëm për punonjësit e shërbimit është 30 deri në 45 ditë kalendarike dhe jepet i shkallëzuar, sipas niveleve e gradave.

3. Periudha e lejes pa të drejtë pagese nuk llogaritet në vjetërsi pune e shërbimi dhe as për efekt të ecurisë në karrierë.

4. Kriteret dhe masat e përfitimeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 53

Dhënia e pensionit dhe përfitimeve suplementare

1. Punonjësi i SHKB-së, përveç përfitimeve, që rrjedhin nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, barazohet me punonjësit e Policisë së Shtetit dhe gëzon të drejtën e përfitimeve të tjera shtesë, sipas kushteve e kriterëve të përcaktuara në ligjin nr.8661, datë 18.9.2000 “Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”.

2. Për efekt të përfitimeve nga ligji nr. 8661, datë 18.9.2000, koha e shërbimit si punonjës i Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, nga e cila buron e drejta e përfitimeve suplementare, përfshin kohën:

a) e studimit në shkollat e larta ushtarake, të Ministrisë së Brendshme, të Policisë së Shtetit apo në shkolla të larta, me natyrë të ngjashme me to;

b) kur është njohur si punonjës i SHKB-së;

c) kur është njohur si ushtarak i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si punonjës i Policisë së Shtetit e i Gardës së Republikës, si punonjës i Shërbimit Informativ të Shtetit, si punonjës i Shërbimit Informativ Ushtarak ose si punonjës në çdo vend të administratës shtetërore, për periudhën që ka ushtruar kompetencat e hetimit të veprave penale;

ç) e ndërprerjes së karrierës në shërbim, për shkak të një vendimi të padrejtë, të cilësuar si të tillë nga gjykata;

d) e trajtimit me pagesë kalimtare;

dh) e njohur si pension i parakohshëm për vjetërsi shërbimi;

e) gjysmën e kohës si punonjës në sektorët joushtarakë, para pranimit si punonjës i SHKB-së;

ë) e qëndrimit në dispozicion, për shkak të pritjes për sistemim në një funksion tjetër, në përputhje me gradën;

f) e shërbimit, që njihet një herë e gjysmë, për funksione të veçanta, me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në çdo rast, periudha gjashtë muaj e një ditë quhet vit i plotë.

3. Punonjësit të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm i jepen shpërblime për punë cilësore, për nevoja kulturore, për raste fatkeqësish dhe raste të tjera të kësaj natyre, sipas kriterëve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 54

Trajtimi me veshmbathje dhe uniformë

1. Punonjësi i Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm trajtohet me veshmbathje në vlerë, një herë në vit, në masën e një page mujore të vendit të punës.

2. Njësi të veçanta të shërbimit pajisen me uniformë, të cilën e përdorin vetëm gjatë ushtrimit të detyrës, kur kërkohet përdorimi i saj. Uniforma dhe mbajtja e saj përcaktohen me urdhër të Ministrit të Brendshëm.

Neni 55

Ndihma financiare

1. Kur bashkëshortja/bashkëshorti humbet vendin e punës, për shkak të emërimit ose transferimit në detyrë jashtë vendbanimit të përhershëm të punonjësit, këtij të fundit i jepet një shtesë page, në masën dhe sipas kriterëve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave. Paga e papunësisë jepet në emër të bashkëshortes/bashkëshortit.

2. Koha e qëndrimit pa punë të bashkëshortes/bashkëshortit të punonjësit, për një periudhë deri në 7 vjet, njihet si vjetërsi sigurimi, për efekt përfitimi pensioni pleqërie. Kontributi për këtë periudhë përballohet nga Buxheti i Shtetit. Kriteret dhe masa përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Personat, që e kanë përfituar këtë të drejtë para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë ta përfitojnë këtë pagesë edhe për periudhën e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, por jo më shumë se 15 vjet.

4. Bashkëshortja/bashkëshorti i punonjësit e përfiton pagën e papunësisë edhe për periudhën kur punonjësi nxirret në lirim, për arsye ristrukturimi, ose vdes, por jo më shumë se periudha e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

Neni 56

E drejta për sigurim banese

1. Punonjësve të SHKB-së, që kanë nevojë për strehim ose për sipërfaqe më të madhe banimi, u jepet kredi, sipas kriterëve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Punonjësi i shërbimit, i trajtuar sipas këtij neni, kur del në lirim, për arsye ristrukturimi dhe nuk i ka shlyer detyrimet përkatëse, vazhdon t'i shlyejë ato si punonjësit në detyrë.

3. Nuk përfitojnë, sipas këtij neni, punonjësit e përjashtuar nga SHKB-ja.

Neni 57

Baza e të dhënave të shenjave të gishtave dhe ADN-së së punonjësve të SHKB-së

1. Shenjat e gishtave dhe mostra e ADN-së e të gjithë punonjësve të SHKB-së ruhen në një bazë të dhënash në laboratorin e policisë shkencore, për të përjashtuar të dhënat e tyre nga ato të proceseve. Ruajtja e të dhënave i shërben procesit të rekrutimit për ata që aplikojnë për t'u pranuar në Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm dhe këto të dhëna u merren të gjithë punonjësve në shërbim, nëse nuk u janë marrë në çastin e marrjes në punë.

2. Shenjat e gishtave dhe mostra e ADN-së, të marra për të krijuar këtë bazë të dhënash, shkatërrohen, qoftë në letër apo në formë elektronike, sapo një punonjës del në pension, lirohet apo përjashtohet nga SHKB-ja.

3. Nëse një punonjës i SHKB-së rikthehet, shenjat e gishtave dhe mostra e ADN-së rimerren.

KREU IV

PROCESI DISIPLINOR

Neni 58

Masa disiplinore

1. Çdo veprim ose mosveprim, kur nuk përbën vepër penale, që bie në kundërshtim me

rregulloren e disiplinës, vlerësohet shkelje disiplinore e punonjësit të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm.

2. Masat për shkeljet disiplinore jepen sipas një procedure administrative, e cila garanton të drejtën për t'u vënë në dijeni, për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur dhe për t'u ankuar.

3. Rregullorja e disiplinës miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 59

Llojet e masave disiplinore

1. Shkeljet ligjore dhe mospërbushja e rregullt e detyrës ndëshkohen deri në përjashtim nga SHKB-ja. Përveç shkeljeve më të rënda, dhënia e masave disiplinore duhet të jetë e përshkallëzuar.

2. Llojet e masave disiplinore, veç masave paraprake, të shprehura në rregulloren e disiplinës, janë:

a) vërejtje me shkrim;

b) gjobë, në masën sa paga e punonjësit nga pesë deri në pesëmbëdhjetë ditë pune;

c) shtyrje e afatit të gradimit edhe për 12 muaj;

ç) ulje në gradë, pa të drejtë konkurrimi për ngritje në gradën e mëparshme, për 2 vjet;

d) përjashtim nga ky shërbim.

3. Masa disiplinore e dhënë duhet të jetë në përputhje me shkeljen e kryer dhe me pasojat e ardhura prej saj.

4. Ankimi në gjykatë nuk pezullon ekzekutimin e masës disiplinore.

Neni 60

Dhënia e masës disiplinore

1. Autoriteti, që jep masën disiplinore, përcaktohet në rregulloren e disiplinës.

2. Masa disiplinore i komunikohet me shkrim vetë punonjësit, brenda 3 ditëve pune nga data e marrjes së vendimit, duke e njoftuar për të drejtën që ka për të apeluar.

3. Punonjësi i SHKB-së, i ndëshkuar me një masë disiplinore, ka të drejtë të marrë pjesë në procesin disiplinor dhe të ndihmohet nga një punonjës i SHKB-së, i zgjedhur prej tij, me të njëjtën gradë ose me gradë më të lartë.

Neni 61

E drejta për ankim

1. Punonjësi i SHKB-së, ndaj të cilit merret një masë disiplinore, ka të drejtë të ankohet me shkrim pranë strukturës së personelit, brenda 5 ditëve nga data, kur vihet në dijeni për dhënien e masës disiplinore. Për shqyrtimin e ankimit, krijohet një komision, funksionimi i të cilit përcaktohet në rregulloren e disiplinës.

2. Procedura e shqyrtimit të masave disiplinore përcaktohet në rregulloren e disiplinës. Punonjësit të ndëshkuar i garantohen të drejtat për t'u mbrojtur, për t'u njohur me materialet e çështjes dhe për t'u njoftuar brenda një afati të arsyeshëm. Mosparaqitja pa shkaqe të arsyeshme e punonjësit të këtij shërbimi nuk e pengon shqyrtimin e çështjes.

3. Masa disiplinore nuk mund të jepet, nëse nuk i komunikohet me shkrim punonjësit brenda 30 ditëve nga data konstatimit të shkeljes apo nëse nuk është zbuluar brenda 2 vjetëve nga koha e kryerjes së saj.

4. Afati 30-ditor i komunikimit të masës mund të shtyhet nga drejtori i SHKB-së, për shkaqe që lidhen me ecurinë e hetimit të shkeljes. Në këto raste, shtyrja e afatit bazohet në një raport me shkrim, që i dërgohet drejtorit të SHKB-së çdo 30 ditë.

5. Punonjësi i SHKB-së, ndaj të cilit merret një masë disiplinore, ka të drejtë të ankohet, sipas Kodit të Procedurave Administrative.

6. Mosrespektimi i afateve nga SHKB-ja është shkak për pushimin e procesit disiplinor.

Neni 62

Shuarja e masës disiplinore

1. Masat disiplinore shuhet nga një deri në pesë vjet, sipas afateve të përcaktuara në rregulloren e disiplinës. Masa e uljes në gradë shuhet në çastin e rifitimit, pas konkurrimit, të gradës së mëparshme. Masa e “përgjashtimit nga shërbimi” nuk shuhet dhe qëndron përgjithmonë në dosjen personale të ish-punonjësit.

2. Pas kalimit të periudhave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, i gjithë dokumentacioni, që lidhet me masat disiplinore, vendoset në qendrën e të dhënave të njësisë së personelit dhe ruhet gjatë të gjithë kohës së punës të punonjësit.

Neni 63

Rregullorja e disiplinës

Kategoritë dhe llojet e shkeljeve disiplinore, kriteret, rregullat, procedurat dhe dokumentacioni për dhënien e masave disiplinore, si dhe përbërja, mënyra e organizimit dhe e funksionimit të komisionit të apelimit të punonjësve të SHKB-së përcaktohen në rregulloren e disiplinës.

Neni 64

Hetimi i pavarur i sjelljes së punonjësit të SHKB-së

1. Procedurat për hetimin e ankesave ndaj punonjësve të SHKB-së parashikohen në rregulloren e disiplinës.

2. Kur shkelja përbën vepër penale, hetohet nga zyra e prokurorisë që e ka në juridiksion.

Neni 65

Pezullimi nga SHKB-ja

1. Pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënieve të punës për periudhën sa zgjat arsyerja e ndërprerjes. Në mbarim të kësaj periudhe, punonjësi rimerr vendin e punës në këtë shërbim ose përjashtohet prej tij.

2. Punonjësi i SHKB-së pezullohet, me urdhër të drejtorit, kur:

a) ndaj tij fillon ndjekja penale, deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë;

b) ndaj tij fillon një hetim, i brendshëm ose i jashtëm dhe qenia e tij në detyrë cenon objektivitetin e hetimit. Në këtë rast, afati i pezullimit dhe shtyrja e afatit përcaktohen nga drejtori i SHKB-së.

3. Në rastet e pushimit të çështjes ose marrjes së pafajësisë, punonjësi duhet t'i nënshtrohet procedimit disiplinor, sipas nenit 59 e në vijim të këtij ligji. Gjatë periudhës së pezullimit punonjësi trajtohet me pagën bazë.

4. Në rast se pas shqyrtimit të çështjes rezulton se punonjësi nuk ka bërë shkelje penale ose disiplinore, ai rifiton të gjitha të drejtat.

5. Në rast se pas shqyrtimit të çështjes rezulton se punonjësi ka bërë shkelje penale ose disiplinore, periudha e kohës së pezullimit nga detyra njihet si vjetërsi shërbimi vetëm për efekt të sigurimeve shoqërore.

KREU V

GRADAT NË SHËRBIMIN E KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Neni 66

Kuptimi i gradave, sistemi i tyre dhe karriera

1. Sistemi i gradave përcakton hierarkinë e punonjësit hetues në strukturën e SHKB-së, nivelet e administrimit dhe pasqyron marrëdhëniet ndërmjet funksioneve.

2. Karriera, e shprehur me hierarkinë e gradave dhe të funksioneve, është rendi i përgjegjësisë të punonjësit gjatë kohës që shërben në SHKB, sipas arsimit, kualifikimit, aftësive drejtuese e profesionale dhe vjetërsisë së shërbimit.

Neni 67

Nivelet

1. Nivelet pasqyrojnë nivelin e organizimit, të drejtimit, kontrollit dhe kryerjes së detyrave në SHKB, si dhe tregojnë pozitën e punonjësve në strukturën e administratës së këtij shërbimi.
2. Emërtimet e niveleve të SHKB-së, sipas hierarkisë, janë:
 - a) punonjës i nivelit zbatues, që përfaqëson nivelin bazë të veprimit;
 - b) punonjës i nivelit të parë drejtues, që përfaqëson drejtimin dhe veprimin operacional;
 - c) punonjës i nivelit të mesëm drejtues, që përfaqëson drejtimin ekzekutiv, qendror dhe/ose vendor;
 - ç) punonjës i nivelit të lartë drejtues, që përfaqëson drejtimin strategjik.

Neni 68

Gradat për personelin hetues

1. Emërtimet e gradave në SHKB, sipas niveleve dhe ecures në karrierë, janë:
 - a) Punonjës i nivelit zbatues:
 - i) asistent;
 - ii) agjent;
 - iii) agjent i parë;
 - iv) hetues.
 - b) Punonjës i nivelit të parë drejtues:
 - i) hetues i parë.
 - c) Punonjës i nivelit të mesëm drejtues:
 - i) drejtues i SHKB-së;
 - ii) drejtues i parë i SHKB-së.
 - ç) Punonjës i nivelit të lartë drejtues:
 - i) Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i SHKB-së;
 - ii) Drejtor i Përgjithshëm i SHKB-së.
2. Tabela e funksioneve, që i përgjigjet çdo grade, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 69

Ngritja në gradë

1. Ngritja në gradë në SHKB bëhet me konkurrim, që nënkupton, krahas raportit të vlerësimit të punës, edhe një provim, ku testohen aftësitë e aplikantëve për gradën pasardhëse.
2. Grada “Asistent” i jepet kursantit me arsim të mesëm pas përfundimit me sukses të periudhës së kryerjes së shkollimit apo kursit përkatës, sipas vendit të punës. Kjo gradë mbahet nga punonjësi i SHKB-së gjatë periudhës së provës, të përcaktuar në nenin 37. Ngritja në gradën “Agjent” bëhet pas përfundimit me sukses të periudhës së kursit dhe periudhës së provës.
3. Grada “Hetues” i jepet punonjësit me arsim të lartë dhe me përvojë pune jo më pak se tri vite në sektorë të policisë, të shërbimeve informative dhe të hetimit, pas përfundimit me sukses të periudhës së kryerjes së kursit përkatës, sipas vendit të punës. Kjo gradë mbahet nga punonjësi i SHKB-së gjatë periudhës së provës. Ngritja në gradën “Hetues i parë” bëhet pas përfundimit me sukses të periudhës së kursit dhe periudhës së provës.
4. Punonjësit të SHKB-së i lind e drejta të aplikojë për të konkurruar në procesin e përzgjedhjes, pas plotësimit të kohës së qëndrimit në gradë, sipas afateve të mëposhtme:
 - a) nga “Agjent” në “Agjent i parë” 3 vjet;
 - b) nga “Hetues” në “Hetues i parë” 3 vjet;
 - c) nga “Hetues i parë” në “Drejtues i SHKB-së” 3 vjet;
 - ç) nga “Drejtues i SHKB-së” në “Drejtues i parë i SHKB-së” 3 vjet;
 - d) nga “Drejtues i parë i SHKB-së” në “Zëvendësdrejtor i SHKB-së” 3 vjet;
 - dh) nga “Zëvendësdrejtor i SHKB-së” në “Drejtor i SHKB-së” pa afat kohor.

5. Në vjetërsinë për efekt gradimi llogaritet edhe koha:
- a) e ndërprerjes së karrierës, për shkak të paaftësisë së përkohshme shëndetësore;
 - b) e paaftësisë shëndetësore, e cila nuk ka ardhur si pasojë e punës, deri në 6 muaj brenda afatit 12-mujor;
 - c) e pezullimit apo e përjashtimit për shkaqe disiplinore, si rezultat i një urdhri ose vendimi të paligjshëm dhe/ose të padrejtë;
 - ç) e pezullimit me pagesë deri në përfundimin e hetimit të një kallëzimi ose një ankese për sjellje në kundërshtim me rregulloren e disiplinës, derisa autoriteti përgjegjës të marrë vendimin përfundimtar për çështjen;
 - d) kur është njohur si ushtarak i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si punonjës i Policisë së Shtetit, si punonjës i Gardës së Republikës, si punonjës i Shërbimit Informativ të Shtetit, si punonjës i Shërbimit Informativ Ushtarak ose si punonjës në çdo vend të administratës shtetërore, për periudhën që ka ushtruar kompetencat e hetimit të veprave penale;
 - dh) në një të dytën e saj si punonjës në sektorët joushtarakë, para pranimit si punonjës i SHKB-së;
 - e) e qëndrimit në dispozicion, në pritje për sistemimin në një funksion tjetër, në përputhje me gradën.
- Në çdo rast, periudha gjashtë muaj e një ditë quhet vit i plotë.
6. Në vjetërsinë për efekt gradimi nuk llogaritet koha e ndërprerjes së karrierës për shkak të:
- a) lejes së përfutur pa të drejtë pagese;
 - b) pezullimeve për shkaqe disiplinore.
7. Punonjësi i SHKB-së ka të drejtë të ankohet te drejtori i SHKB-së, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, në rastet kur vëren shkelje të rregullave të ngritjes në gradë, të përcaktuara në këtë nen dhe në rregulloren e personelit.
8. Procedurat për kryerjen e provimeve të ngritjes në gradë përcaktohen në rregulloren e personelit dhe përfshijnë:
- a) përbërjen e komisioneve të testimit;
 - b) procedurat e aplikimit;
 - c) kriteret për të aplikuar;
 - ç) strukturën e provimeve, për ngritje në gradë;
 - d) përcaktimin dhe kohëzgjatjen e listës emërore, sipas radhës, të personave që kanë të drejtë të ndjekin kursin për këtë qëllim.

Neni 70

Fitimi i gradës

1. Ngritja në gradë e punonjësit të SHKB-së nënkupton ngritjen e tij në detyrë, sipas tabelës së funksioneve, që i përgjigjet çdo grade, sipas nenit 69 të këtij ligji. Ngritja në gradë bëhet vetëm për të plotësuar vendet e lira për çdo gradë. Në urdhrin për ngritje në gradë, autoriteti përgjegjës përcakton edhe funksionin përkatës të punonjësit.
2. Procedurat e fitimit të gradës përcaktohen në rregulloren e personelit, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 71

Heqja dorë nga grada

1. Punonjësi i SHKB-së ka të drejtë të kërkojë të heqë dorë nga grada që mban, për të kaluar në një gradë më të ulët.
2. Heqja dorë nga grada, sipas pikës 1 të këtij neni, mund të kërkohet vetëm për një gradë paraardhëse dhe jo më shumë se në dy raste gjatë karrierës si punonjës i SHKB-së.
3. Vendimi për kërkesën e punonjësit për heqje dorë nga grada merret nga autoriteti përkatës, që e ka dhënë atë.
4. Punonjësi i SHKB-së, i cili më parë ka hequr dorë, me kërkesën e vet, nga një gradë, ka të drejtë të kërkojë ngritje në gradë vetëm pas certifikimit nga komisioni i testimit dhe sipas procedurave të përcaktuara për ngritjen e fitimin e gradës.

Neni 72
Ulja në gradë

1. Me përjashtim të nivelit zbatues, kur, për shkak të ndryshimeve në strukturën organizative të SHKB-së, shkurtohet numri i funksioneve organike për gradë, punonjësi i SHKB-së, që mban gradën ku do të kërkohet ulja, mund të kërkojë, në mënyrë vullnetare, uljen një gradë më poshtë, kur ka vende të lira.

2. Me krijimin e vendeve të lira për gradë, punonjësi i SHKB-së, që ka kërkuar uljen në gradë, rimerr, brenda 2 vjetëve, gradën e mëparshme, sipas të njëjtit kusht, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 73
Ruajtja e gradës

Punonjësi i SHKB-së, që punësohet në struktura të tjera të administratës publike apo në një organizatë ndërkombëtare, në funksione që kanë objekt të punës çështje me natyrë të ngjashme me ato në SHKB-së, rikthehet në të njëjtën gradë, që mbante në çastin e lirimt dhe kjo periudhë i llogaritet vjetërsi, për efekt gradimi.

Neni 74
Klasifikimi i personelit inspektues dhe mbështetës të SHKB-së

1. Personeli inspektues dhe mbështetës i SHKB-së ndahet në këto klasa:
 - a) punonjës të nivelit të lartë drejtues;
 - b) punonjës të nivelit të mesëm drejtues;
 - c) punonjës të nivelit bazë drejtues;
 - ç) punonjës të nivelit bazë zbatues.
2. Klasifikimi i niveleve, sipas funksioneve, bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

PJESA E PESTË
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 75
Dispozita kalimtare dhe nxjerrja e akteve nënligjore

1. Marrëdhëniet e punës dhe trajtimi ekonomiko-financiar i punonjësve të SHKB-së në karrierë edhe pas ndërprerjes së saj, deri në miratimin e akteve nënligjore përkatëse, të parashikuara në këtë ligj, bëhet sipas dispozitave në fuqi.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Brendshëm të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të neneve 7, 8, 11, 12, 13, 17, 20, 22, 23, 24, 25, 33, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 58, 68, 70 dhe 74 të këtij ligji, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 76

1. Ligji nr.8749, datë 1.3.2001 “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Rendit Publik” dhe dispozitat nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

2. Aktet e tjera nënligjore, të nxjerra në zbatim të ligjit nr.8749, datë 1.3.2001 “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Rendit Publik”, shfuqizohen brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 77
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5916, datë 22.10.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 003, datë 6.10.2008

**PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7928, DATË 27.4.1995 “PËR TATIMIN
MBI VLERËN E SHTUAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Neni 24 riformulohet si më poshtë:

“Neni 24
Organizatat jofitimprurëse

Furnizimi i bërë nga një organizatë jofitimprurëse kundrejt pagesës së reduktuar është një furnizim i përjashtuar nëse është:

- a) furnizim shërbimesh nga organizata fetare apo filozofike, me qëllim mirëqenien shpirtërore;
- b) furnizim mallrash e shërbimesh nga organizatat jofitimprurëse, të cilat kanë statusin e organizatave jofitimprurëse për përfitim publik dhe që çmimet e mallrave dhe shërbimeve që ato furnizojnë janë dukshëm më të ulëta se çmimet e tregut.

Statusi i organizatave jofitimprurëse për përfitim publik jepet me autorizim nga Ministri i Financave, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Në nenin 26, pika 2.1. ndryshohet si më poshtë:

“2.1. Për makineritë dhe pajisjet e importuara nga personat e tatueshëm, në kuptim të këtij ligji, në funksion të veprimtarisë së tyre ekonomike, pavarësisht llojit të saj, zbatohet skema e shtyrjes së pagesës së TVSH-së deri në 12 muaj. Për rastet kur cikli i zhvillimit të investimeve dhe fillimit të ofrimit të prodhimit ose të shërbimit është më i gjatë se 12 muaj, Ministri i Financave ka autoritetin ta zgjasë afatin e shtyrjes së pagesës së TVSH-së, në varësi të ciklit të zhvillimit të investimit të parashikuar në marrëveshje apo kontratë. Sipas kësaj skeme, TVSH-ja nuk paguhet në doganë, në çastin e importit.

Skema e re e shtyrjes së pagesës së TVSH-së përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Kriteret dhe procedurat, që do të ndiqen për shtyrjen e TVSH-së, në rastin kur zgjatja e ciklit të investimit dhe fillimit të ofrimit të prodhimit ose të shërbimit është më e gjatë se 12 muaj, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.”.

Neni 3

Në nenin 26/1 bëhen këto ndryshime e shtesa:

1. Shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) importimi përfundimtar i të gjitha mallrave prej një personi të tatueshëm, kur furnizimi i tyre në të gjitha rrethanat, brenda vendit, është furnizim i përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar. Kjo shkronjë nuk zbatohet për furnizimin në import të shtypshkrimeve dhe librave të çdo lloji;”.

2. Pas shkronjës “e” shtohen shkronjat “ë” dhe “f” me këtë përmbajtje:

“ë) importimi i mjeteve, të cilat ndihmojnë në integrimin në jetë të invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, përfshirë këtu dhe autovetura të përshtatura për përdorim prej tyre;

f) importimi i anijeve, sipas nënkrerëve 8901 20, 8901 30, 8901 90, 8902 00 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.”.

Neni 4

Në nenin 55, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Në mungesë të emërimit të një përfaqësuesi tatimor, të gjitha detyrimet dhe penalitetet për to paguhen nga përfituesi vendas i furnizimit.”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5917, datë 22.10.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr.10 004, datë 9.10.2008

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES KUADËR TË HUASË NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË EUROPËS (CEDB) PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “REHABILITIMI I SPITALIT RAJONAL TË SHKODRËS – FAZA E TRETË””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja kuadër e huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEDB) për financimin e projektit “Rehabilitimi i spitalit rajonal të Shkodrës – faza e tretë””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.5918, datë 22.10.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE KUADËR HUAJE

NDËRMJET BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË EUROPËS DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE, QË PËRFAQËSON REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës, organizatë ndërkombëtare, Paris (këtu quhet CEB), nga njëra anë, dhe Këshilli i Ministrave, që përfaqëson Republikën e Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave (këtu quhet Huamarrësi),

- duke pasur parasysh kërkesën e paraqitur nga qeveria anëtare shqiptare, të datës 15 tetor 2007;

- duke pasur parasysh protokollin e tretë të marrëveshjes së përgjithshme mbi privilegjet dhe imunitetet e Këshillit të Europës;

- duke pasur parasysh rezolutën e këshillit administrativ të CEB-it: 1495 (2006);

- duke pasur parasysh rregulloren e huasë së CEB-it, të qershorit 2006 (këtu dhe më tej, rregullore e huasë),

kanë rënë dakord sa më poshtë.

Përkufizime

“Alokimi i një transhi (këtu dhe më tej, gjithashtu, “alokimi” ose “alokuar”)” është angazhimi i një transhi nga Huamarrësi të pjesët përbërëse të projektit (të identifikuar nëpërmjet një table standard, që i bashkëngjitet kësaj Marrëveshjeje kuadër huaje) edhe nëse ky transh nuk është paguar akoma për projektin.

“Data e parashikuar për përfundimin e projektit” është data e pritshme për përfundimin fizik të projektit, sipas përcaktimit nga Huamarrësi në momentin e aprovimit të projektit nga këshilli administrativ i CEB-it ose komiteti i tij ekzekutiv, siç tregohet në nenin 3.3.

“Ditë punë” është një ditë në të cilën sistemi TARGET (Trans-European Automated Real-time Gross Settlement Express Transfer System)¹ është në veprim.

“Datë e mbylljes” është data që bie gjashtë muaj pas datës së parashikuar për përfundimin e projektit, siç tregohet në nenin 3.5.

“Udhëzimet e CEB-it për prokurimet” janë udhëzimet që përmenden në rezolutën 1495 në dokumentin 2: Manual për përgatitjen dhe monitorimin e projekteve, shtojca B “Parimet për prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve”.

“EURIBOR” (Euro Interbank Offered Rate) është norma në të cilën depozitat me afat ndërbankar në euro brenda zonës së euros ofrohen nga një bankë kryesore të një bankë tjetër kryesore. Kjo sponsorizohet nga Federata Bankare Europiane, e llogaritur nga Reuters dhe publikuar çdo ditë punë në Bruksel në orën 11.00 në faqen e Reuters EURIBOR01.

“Përfituesi përfundimtar” është subjekti moral ose ligjor, ose grupi shoqëror që përfiton nga efektet sociale të projektit.

“Konventa e ditës pasuese të modifikuar të punës” është një konventë, nëpërmjet së cilës nëse një datë e caktuar do të binte në një ditë që nuk është ditë punë, kjo datë do të jetë dita e parë pasuese që është një ditë punë, nëse kjo ditë nuk bie në muajin tjetër kalendarik, rast në të cilin ajo datë do të ishte dita e parë para asaj që është ditë punë.

“Agjenci zbatuese e projektit” (këtu e më tej quhet PIA) është autoriteti publik, që, me anë të delegimit nga Huamarrësi, zbaton dhe menaxhon projektin.

“Njësia e zbatimit të projektit” (këtu e më tej quhet PIU) është ekipi i PIA-s i ngarkuar me zbatimin e përditshëm, menaxhimin fizik dhe financiar, dhe vazhdimin e projektit.

“Gjendja e planifikuar e ecurisë së punëve” është raporti ndërmjet shpenzimeve të pranueshme, për të gjitha pjesët përbërëse të projektit, dhe kostos totale të përgjithshme të projektit, ku shpenzimet e përshtatshme përfshijnë shpenzimet e kryera, si dhe ato që pritet të kryhen për një periudhë të caktuar kohe që nuk kalon një vit nga data e raportit të monitorimit (sipas përcaktimit në nenin 4.2.2 më poshtë).

¹ Për monedhat e ndryshme nga euro. Përkufizimi i një dite punë do të përcaktohet në një letër shoqëruese.

“Gjendja e ecurisë së punëve” është raporti ndërmjet shpenzimeve të pranueshme të kryera, për të gjitha pjesët e projektit dhe kostos totale të përshtatshme të projektit.

“Transh” është shuma e disbursuar ose që do të disbursohet nga huaja.

Neni 1

Kushtet

Huaja jepet në bazë të kushteve të përgjithshme të rregulloreve të huasë dhe në bazë të kushteve të veçanta të caktuara nga kjo Marrëveshje kuadër huaje (këtu quhet Marrëveshja), shtojcat e saj dhe letrat shoqëruese (këtu quhen letrat shoqëruese).

Neni 2

Projekti

CEB-i i jep Huamarrësit, i cili pranon një hua (këtu quhet huaja) për financimin e pjesshëm të F/P 1385 Add 4 (2007) të aprovuar nga këshilli administrativ i CEB-it në 14 nëntor 2007 dhe në lidhje me rehabilitimin e spitalit rajonal të Shkodrës - faza e tretë.

Huaja jepet nga CEB-i duke pasur parasysh detyrimin që Huamarrësi po merr përsipër për ta zbatuar atë vetëm për financimin e projektit të përshkruar në shtojcën 1 (këtu quhet projekti) dhe për të zbatuar këtë projekt sipas kushteve që janë të detajuara në këtë shtojcë.

Çdo ndryshim në lidhje me mënyrën si zbatohet huaja që nuk ka marrë pëlqimin e CEB-it mund të shkaktojë pezullimin, anulimin ose rimbursimin e parakohshëm të huasë, sipas kushteve të neneve 3.3, 3.5 dhe 3.6 të rregulloreve të huasë.

Neni 3

Huaja

3.1 Kushtet financiare

Shuma e huasë së dhënë është: EUR -6 000 000, gjashtë milionë euro. Ai do të disbursohet në transhe.

Për secilin transh, shuma, interesi, monedha, data e disbursimit, periudha e shlyeres deri në 20 vjet nga data e disbursimit dhe llogaritë e secilës palë për dërgim përcaktohen së bashku me Huamarrësin dhe CEB-in me faks.

Një letër shoqëruese e Marrëveshjes, që përcakton kushtet për secilin transh do të hartohet në momentin e disbursimit, kryesisht në formën e përcaktuar në shtojcën 2/a dhe shtojcën 2/b.

3.2 Kontributi nga llogaria përzgjedhëse e mirëbesimit

Interesi për secilin transh huaje do të subvencionohet nëpërmjet llogarisë përzgjedhëse të mirëbesimit. Ky subvencion nuk mund të kalojë 792 000 euro për shumën e plotë të projektit të aprovuar nga këshilli administrativ i CEB-it. Subvencioni do të zbatohet proporcionalisht për secilin transh të huasë. Sidoqoftë, në rast se norma e interesit para subvencionimit do të ishte poshtë normës së subvencionit, subvencioni do të jetë i barabartë me atë normë.

3.3 Kontributi nga llogaria norvegjeze e mirëbesimit (NTA)

Një komponent i asistencës teknike, i bazuar në një grant prej 150 000 eurosh do të merret prej llogarisë norvegjeze të mirëbesimit të CEB-it (shih hollësitë në shtojcën 1 më poshtë).

3.4 Disbursimi

CEB-i do të disbursojë huanë në një minimum prej dy transhesh. Shuma e transhit do të përcaktohet në përputhje me gjendjen e ecurisë së punëve dhe/ose gjendjen e pritshme të ecurisë së punëve. Disbursimi i parë duhet të kryhet brenda 18 muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje sipas përkufizimit në nenin 15.

Transhi i parë nuk do të kalojë 50% të shumës së miratuar të huasë. Transhet do të disbursohen në një llogari speciale të çelur në Bankën Qendrore të Shqipërisë në emër të Huamarrësit. PIA do të mbajë një llogari të veçantë në një bankë të nivelit të dytë në Shqipëri për aktivitetet që do të ndërmerren sipas këtij projekti. Të ardhurat prej huasë do të transferohen në llogarinë e veçantë të lartpërmendur me kërkesë të PIU-t.

Çdo transh pasues, me përjashtim të transhit të parë, mund të disbursohet vetëm pasi

Huamarrësi i konfirmon me shkrim CEB-it, duke përmbushur nenin 4.2.2 më poshtë, alokimin e plotë të transhit të mëparshëm. Transhet pasuese do të llogariten mbi bazën e gjendjes së ecurisë së punëve, dhe - nëse mendohet e përshtatshme - të gjendjes së planifikuar të ecurisë së punëve.

3.5 Data e pritshme e përfundimit të projektit dhe data e mbylljes

Data e parashikuar e përfundimit të projektit është 31 dhjetor 2010. Data e mbylljes është 30 qershor 2011. Nga kjo datë, dhe nëpërmjet një njoftimi të CEB-it drejtuar Huamarrësit, asnjë tërheqje tjetër nuk mund të bëhet nga Huamarrësi.

3.6 Hollësitë e pagesës

Të gjitha shumat e kërkueshme prej Huamarrësit në bazë të kësaj Marrëveshjeje paguhen në monedhën e secilit transh në numrin e llogarisë së komunikuar nga CEB-i Huamarrësit në momentin e disbursimit.

Huamarrësi ose banka e udhëzuar nga Huamarrësi, sipas rastit, dërgon një njoftim me shkrim për pagesën tek CEB-i të paktën pesë ditë punë para pagesës së çdo shume të kërkueshme në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

Çdo pagesë sipas kësaj Marrëveshjeje bëhet në një ditë punë në pajtim me konventën e modifikuar të ditës pasuese të punës.

Neni 4

Monitorimi i huasë dhe projektit

4.1 Përdorimi i huasë

4.1.1 Periudha

Transhet duhet t'i alokohen projektit nga Huamarrësi brenda 12 muajve pas secilit disbursim. Shuma që nuk alokohet në projekt brenda kësaj periudhe duhet t'i kthehet CEB-it, maksimumi, brenda 30 ditëve.

Huamarrësi merr përsipër të mbulojë shpenzimet që rrjedhin nga kjo shlyerje. Ky shpenzim përfshin atë që duhet të mbulojë CEB-i për shkak të riinvestimit të së njëjtës shumë në datën e shlyerjes për periudhën që mbetet të huasë fillestare, si dhe çdo shpenzim tjetër dytësor. Norma e riinvestimit caktohet nga CEB-i mbi bazën e kushteve të tregut në datën e shlyerjes për periudhën në fjalë. Kostoja do të llogaritet duke pasur parasysh diferencën ndërmjet normës origjinale dhe normës së riinvestimit.

Për më tepër, nëse një transh i disbursuar nga CEB-i nuk alokohet në projekt ose alokohet vetëm pjesërisht në të brenda periudhës së përmendur në paragrafin e parë të mësipërm, kjo do të përbënte një ngjarje të renditur në nenin 3.3 (h) të kapitullit 3 të rregulloreve të huasë dhe mund të shkaktojë pezullimin, anulimin ose rimbursimin e parakohshëm të huasë sipas kushteve të neneve 3.3, 3.5 dhe 3.6 të rregulloreve të huasë.

4.1.2 Zbatimi i projektit

Huamarrësi cakton Ministrinë e Shëndetësisë si PIA. PIA do të përdorë të njëjtën njësi zbatimi të projektit (PIU) të ngritur brenda strukturës së saj për projektin F/P 1385 - rehabilitimi i spitalit të Shkodrës, faza e dytë. Sidoqoftë, përgjegjësia për të përmbushur të gjitha detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje i mbetet Huamarrësit.

4.1.2.1 Detyrimi i kujdesit

Huamarrësi do të tregojë gjithë kujdesin dhe vëmendjen e duhur dhe ushtrijë të gjitha mjetet që përdoren zakonisht, veçanërisht mjetet financiare, teknike, sociale dhe menaxheriale dhe ato në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, që do të jenë të nevojshme për zbatimin e duhur të projektit.

4.1.2.2 Kostoja e rritur ose e rishikuar e projektit

Nëse kostot e projektit, sipas përshkrimit në shtojcën 1, të bashkangjitur, rriten ose rishikohen për një arsye të caktuar, Huamarrësi siguron që burimet financiare shtesë për përfundimin e projektit të jenë në dispozicion.

Në mënyrë të veçantë, ai siguron-para zbatimit të projektit- që të gjitha të drejtat financiare mbi tokën dhe pasuritë e paluajtshme që janë të nevojshme për këtë të jenë të disponueshme, dhe të gjitha sendet pasurore dhe pajisjet të jenë të siguruara dhe të mirëmbajtura në mënyrë të përhershme.

Në çdo rast, financimi i pjesshëm nga CEB-i nuk e kalon 60% të koston total të projektit, duke përfshirë interesat dhe pagesat financiare, sipas përcaktimit në shtojcën 1.

4.1.2.3 Prania e CEB-it

Huamarrësi do t'u tregojë përfituesve që projekti financohet pjesërisht nga CEB-i.

4.1.2.4 Detyrime të tjera

Huamarrësi, për më tepër, merr përsipër që:

- zbatimi i projektit përputhet me rregullat përkatëse mbi mashtrimin, korrupsionin dhe pastrimin e parave;
- zbatimi i projektit nuk çon në ndonjë shkelje të konventës europiane për të drejtat e njeriut dhe kartës sociale europiane;
- projekti përputhet me parimet menaxheriale të mjedisit të CEB-it (shtojca 3).

4.1.3 Prokurimi

Punët, mallrat dhe shërbimet e financuara sipas projektit do të prokurohen në pajtim me udhëzimet e CEB-it për prokurimin. CEB-i do të lejojë që punët, mallrat dhe shërbimet e financuara sipas projektit të prokurohen duke përdorur dokumentet standarde për ofertim të Bankës Botërore dhe udhëzimet e Bankës Botërore për përzgjedhjen dhe punësimin e konsulentëve, të rishikuar në maj 2004. Procedurat e prokurimit sipas kufijve të fondit përcaktohen në shtojcën 4.

CEB-i nuk financon shpenzimet për mallrat dhe punët që nuk janë parashikuar në marrëveshjen e grantit dhe siç shtjelohet më tej në planin e prokurimit. Në këto raste, CEB-i do ta deklarojë prokurimin të gabuar dhe sipas politikës së CEB-it anulon atë pjesë të huasë së caktuar për mallrat dhe punët që nuk janë prokuruar siç duhet. Kjo do të përbënte një ngjarje të renditur në nenin 3.3-h të kapitullit 3 të rregulloreve të huasë dhe mund të shkaktojë pezullimin, anulimin ose rimbursimin e parakohshëm të huasë sipas kushteve të neneve 3.3, 3.5 të rregulloreve të huasë.

Huamarrësi nëpërmjet PIA/PIU do të informojë menjëherë CEB-in për çdo vonesë ose detyrime të tjera në grafikun e procesit të prokurimit, që mund të ndikonte ndjeshëm në zbatimin në kohë dhe të suksesshëm të kontratave të projektit, dhe do të bjerë dakord me CEB-in për masat korrigjuese.

CEB-i nuk do të japë asnjë “konfirmim” për masat e prokurimit të propozuara nga Huamarrësi, duke përfshirë grupimin e kontratave, procedurat e zbatueshme, por do të rezervojë të drejtën për të kryer një rishikim para ose pas tyre të dokumentacionit të prokurimit sipas një modeli.

Në çdo rast, përgjegjësia për zbatimin e projektit dhe mbi të gjitha përgjegjësia për dhënien dhe administrimin e kontratave sipas projektit, i mbetet Huamarrësit.

4.2. Kërkesa për informacion

4.2.1 Informacioni në lidhje me projektin

Huamarrësi nëpërmjet PIA/PIU mban regjistra llogarish në lidhje me projektin, që janë në pajtim me standardet ndërkombëtare, duke treguar, në çdo pikë, gjendjen e ecurisë të projektit, dhe që regjistron të gjitha operacionet e bëra dhe identifikon sendet pasurore dhe shërbimet e financuara me ndihmën e huasë.

Huamarrësi nëpërmjet PIA/PIU merr përsipër t'i përgjigjet brenda një afati të arsyeshëm çdo kërkesë për informacion nga CEB-i dhe ta pajisë atë me çdo dokumentacion që CEB-i do ta konsideronte të rëndësishëm dhe mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme, për zbatimin e rregullt të Marrëveshjes, veçanërisht në lidhje me monitorimin e projektit dhe përdorimin e huasë.

Huamarrësi nëpërmjet PIA informon CEB-in menjëherë për çdo ndryshim legjislativ ose rregullator në sektorin ekonomik në lidhje me projektin, dhe, në një kuptim të përgjithshëm, për çdo ngjarje që mund të ketë një efekt mbi përmbushjen e detyrimeve të tij sipas Marrëveshjes. Çdo ndryshim legjislativ ose rregullator në sektorin ekonomik në lidhje me projektin do të përbënte një ngjarje siç renditet në nenin 3.3-h të kapitullit 3 të rregulloreve të huasë dhe mund të shkaktojë pezullimin, anulimin ose rimbursimin e parakohshëm të huasë sipas kushteve të neneve 3.3, 3.5 dhe 3.6 të rregulloreve të huasë.

4.2.2 Raportet e monitorimit

Të paktën një herë në vit, nga disbursimi i huasë deri në përfundimin e të gjithë projektit, Huamarrësi nëpërmjet PIA/PIU i dërgon CEB-it një raport monitorimi. Huamarrësi nëpërmjet PIA/PIU dërgon gjithashtu një raport monitorimi para çdo disbursimi, me përjashtim të transhit të parë. Këta raporte duhet të konsiderohen të kënaqshëm nga CEB-i para se të bëhet ndonjë disbursim.

Shtojca 5 parashikon formatin që përcakton informacionin minimal të kërkuar nga CEB-i për raportet e monitorimit. Mund të përdoren gjithashtu formate alternative që përmbajnë të njëjtin

informacion.

Në çdo rast, raportet e monitorimit trajtojnë:

- gjendjen e alokimit të transheve të disbirsuara të huasë;
- ecurinë e planeve të financimit dhe prokurimit të projektit;
- ecurinë e vetë projektit, në lidhje me ecurinë fizike dhe shpenzimeve të shkaktuara;
- hollësi të menaxhimit të projektit.

4.2.3 Raporti i përfundimit të projektit

Me përfundimin fizik të të gjithë projektit, Huamarrësi nëpërmjet PIA/PIU paraqet një raport përfundimtar që përmban një vlerësim të efekteve ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore të projektit. Ky raport duhet të konsiderohet i kënaqshëm nga CEB-i.

4.2.4 Misionet e monitorimit

Huamarrësi merr përsipër të presë në mënyrë të përshtatshme çdo mision monitorimi të ndërmarrë nga punonjësit e CEB-it ose konsulentët e jashtëm të angazhuar nga CEB-i dhe të sigurojë të gjithë bashkëpunimin e nevojshëm për misionet e tyre të monitorimit, duke lehtësuar çdo vizitë të mundshme në kantierin e projektit. Veçanërisht, CEB-i mund të ndërmarrë një auditim të llogarive të projektit në terren, të kryer nga një ose më shumë konsulentë me zgjedhjen e tij, me shpenzimet e Huamarrësit, në rastin e mospërbushjes prej Huamarrësit të ndonjë prej detyrimeve të tij sipas huasë.

Neni 5

Përbushja e detyrimeve të Huamarrësit

Pas pagesës së shumës së plotë të shumës principale të huasë dhe të gjithë interesit dhe shpenzimeve të tjera që rrjedhin prej saj, veçanërisht shumat sipas neneve 6 dhe 7 më poshtë, Huamarrësi çlirohet tërësisht nga detyrimet e tij kundrejt CEB-it, me përjashtim të atyre të parashikuara në nenet 4.2.1 dhe 4.2.4 më sipër, për qëllimet e një vlerësimi të mundshëm pasues të projektit.

Neni 6

Interesi për vonesat

Për disbursimet në euro, dhe pavarësisht ndonjë mjeti tjetër mbrojtës që ka CEB-i sipas Marrëveshjes dhe rregulloreve të huasë apo të tjera, nëse Huamarrësi nuk e paguan të gjithë interesin ose një shumë tjetër që paguhet sipas Marrëveshjes deri në datën e caktuar të kërkuar, Huamarrësi duhet të paguajë interes shtesë mbi shumën e detyrueshme dhe të papaguar plotësisht, sipas normës një mujore të EURIBOR-it që nga data e caktuar ora 11⁰⁰ (ora lokale në Bruksel), plus 2.5% në vit, që nga data e caktuar e kësaj shume deri në datën e pagesës faktike². Norma e zbatueshme një mujore e EURIBOR-it³ përditësohet çdo 30 ditë.

Neni 7

Kostot shoqëruese

Të gjitha detyrimet dhe taksat e të gjitha llojeve, të detyrueshme dhe të paguara, dhe të gjitha shpenzimet që rezultojnë nga përfundimi, ekzekutimi, likuidimi, anulimi ose pezullimi i kësaj Marrëveshjeje, plotësisht ose pjesërisht, ose nga garancia ose rifinancimi i huasë së dhënë, së bashku me të gjitha aktet gjyqësore dhe ekstrajgyqësore që kanë këtë hua si origjinë përballohen nga Huamarrësi.

Megjithatë, dispozitat e neneve 4.7 të kapitullit 4 të rregulloreve të huasë zbatohen në lidhje me koston e procedurës së arbitrazhit të përmendur në kapitullin përkatës 4.

Neni 8

Barazia dhe pengu negativ

Huamarrësi deklaron që asnjë detyrim tjetër nuk është marrë përsipër dhe nuk do të merret në

² Për monedhat e ndryshme nga euro, fusni dispozitat e zbatueshme në letrat shoqëruese

³ Për monedhat e ndryshme nga euro, fusni dispozitat e zbatueshme në letrat shoqëruese

të ardhmen, e cila mund t'i jepte një pale të tretë një pozicion preferencial, një të drejtë pagese preferenciale, një garanci hipotekore ose garanci të çfarëdo natyre që mund t'u japë më tepër të drejta palëve të treta (këtu dhe më tej mjet sigurimi).

Nëse një mjet i tillë sigurimi megjithatë i është dhënë një pale të tretë, Huamarrësi bie dakord të krijojë ose japë një mjet identik sigurimi në favor të CEB-it ose, nëse ai pengohet për ta bërë këtë, një mjet të barasvlershëm sigurimi, dhe të parashikojë krijimin e një mjeti të tillë sigurimi në favor të CEB-it.

Mospërmbushja e këtyre dispozitave do të përbënte një rast kundërvajtjeje të parashikuar në nenin 3.3-h të kapitullit 3 të rregulloreve të huasë dhe mund të shkaktojë pezullimin, anulimin ose rimbursimin e parakohshëm të huasë sipas kushteve të neneve 3.3, 3.5 dhe 3.6 të rregulloreve të huasë.

Neni 9

Përfaqësimet dhe garancitë

Huamarrësi përfaqëson dhe garanton:

- që organet e veta kompetente menaxheriale e kanë autorizuar atë të lidhë marrëveshjen dhe u kanë dhënë nënshkruesve autorizimin për këtë, në pajtim me ligjet, dekretet, rregulloret, nenet e themelimit dhe tekste të tjera që zbatohen për të;

- që hartimi dhe përfundimi i Marrëveshjes nuk bie në kundërshtim me ligjet, dekretet, rregulloret, nenet e themelimit ose tekste të tjera të zbatueshme për të dhe që të gjitha lejet, licencat dhe autorizimet e nevojshme për të janë marrë dhe do të mbeten të vlefshme për të gjithë periudhën e huasë.

Çdo ndryshim në lidhje me përfaqësimet dhe garancitë, për të gjithë periudhën e huasë, duhet t'i njoftohet CEB-it menjëherë dhe t'i jepet çdo dokument shoqërues.

Neni 10

Marrëdhëniet me palët e treta

Huamarrësi nuk mund t'i referohet asnjë fakti, brenda objektit të përdorimit të huasë, në lidhje me marrëdhëniet me palët e treta, me qëllim që të mënjanojë përmbushjen, plotësisht ose pjesërisht, të detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja.

CEB-i nuk mund të përfshihet në mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Huamarrësit dhe palëve të treta dhe në shpenzimet, cilado qoftë natyra e tyre, të shkaktuara nga CEB-i për shkak të ndonjë pretendimi, dhe veçanërisht të gjitha shpenzimet ligjore ose gjyqësore do të mbulohen nga Huamarrësi.

Neni 11

Interpretimi i Marrëveshjes

Huamarrësi deklaron që ai ka marrë një kopje të rregulloreve të huasë dhe e merr parasysht atë. Nëse ka një kontradiktë ndërmjet një dispozite të caktuar të rregulloreve të huasë dhe një dispozite tjetër të Marrëveshjes, mbizotëron dispozita e Marrëveshjes.

Titujt e paragrafëve, seksioneve dhe kapitujve të Marrëveshjes nuk shërbejnë për interpretimin e saj.

Në asnjë rast nuk prezumohet që CEB-i në heshtje ka hequr dorë nga të drejtat, që asaj i jepen nga Marrëveshja.

Neni 12

Ligji i zbatueshëm

Marrëveshjet dhe letrat me vlerë të negociueshme në lidhje me të rregullohen nga rregullat e CEB-it sipas parashikimit në dispozitat e nenit 1, paragrafi 3, të protokollit të tretë (datë 6 mars 1959) të marrëveshjes së përgjithshme mbi privilegjet dhe imunitetet e Këshillit të Europës (datë 2 shtator 1949), dhe, në radhë të dytë, nëse paraqitet e nevojshme, nga ligji francez.

Mosmarrëveshjet ndërmjet palëve në Marrëveshje i nënshtrohen arbitrazhit sipas kushteve të

parashikuara në kapitullin 4 të rregulloreve të huasë.

Neni 13

Ekzekutimi i një vendimi arbitrazhi

Palët kontraktuese bien dakord të mos përfitojnë nga asnjë privilegj, imunitet ose legjislacion para një autoriteti juridiksional ose tjetër, qoftë i vendit apo i huaj, me qëllim që të kundërshtojë ekzekutimin e një vendimi arbitrazhi të dhënë në kushtet e parashikuara në kapitullin 4 të rregulloreve të huasë.

Neni 14

Njoftimet

Çdo njoftim ose komunikim tjetër, që duhet të jepet ose bëhet në pajtim me këtë Marrëveshje për CEB-in ose Huamarrësin, do të jetë me shkrim dhe do të mendohet të jetë bërë ose dhënë siç duhet kur ai dorëzohet dorazi, me postë ajrore ose faks nga një palë te tjetra në adresën e mëposhtme të caktuar më poshtë.

Për Huamarrësin:
Ministria e Financave
Tiranë, Republika e Shqipërisë
Në vëmendje të: Ministrit të Financave
Faks: + 355 4 22 84 94

Për CEB-in:
Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës
55 Avenue Kléber
75116, Paris
Në vëmendje të: Drejtorisë së Përgjithshme për Huatë
Faks: +33 147 55 37 52

Të gjitha komunikimet e bëra ose të dorëzuara do të jenë në gjuhën angleze.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas nënshkrimit nga CEB-i dhe Huamarrësi dhe ratifikimit nga Parlamenti i Shqipërisë.

Neni 16

Kopjet origjinale të Marrëveshjes

Marrëveshja hartohet në dy kopje origjinale, ku secila është njëlloj e barasvlershme. Një origjinal mbahet nga secila prej palëve kontraktuese.

Paris
Më
Për Huamarrësin
Ministri i Financave

Paris
Më
Për CEB-in
Guvematori/zëvendësguvernatori

LISTA E SHTOJCAVE

SHTOJCA 1:	Përshkrimi i projektit
SHTOJCA 2/a:	Letra shoqëruese (formati)
SHTOJCA 2/b:	Letra shoqëruese (formati)

SHTOJCA 3: Parimet e menaxhimit të mjedisit
 SHTOJCA 4: Procedurat e prokurimit sipas kufijve të fondit limit
 SHTOJCA 5: Raportet e monitorimit (formate)

SHTOJCA 1
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

I

F/P	1385 Add 4 (2007)
Huamarrësi	Këshilli i Ministrave që përfaqëson Republikën e Shqipërisë
Aprovimi nga këshilli administrativ	14 nëntor 2007
Shuma e aprovuar	6 000 000 euro

II

Zona e ndërhyrjes	Projekti synon vazhdimin e rehabilitimit të spitalit të Shkodrës, në pajtim me planin e përgjithshëm të ndërtimit dhe të rehabilitimit të përmirësuar (master plani)					
Punët e planifikuara	Punët kryesore të planifikuara të fazës së tretë do të jenë: i) Përfundimi i realizimit të departamenteve dhe shërbimeve që përfshihen në master planin fillestar (rehabilitimi i spitalit psikiatrik, spitalit pediatrik, ndërtesës ndërmjetëse dhe ndërtimi i godinave të reja për departamentin e endoskopisë, pavionit të pacientëve për sëmundje akute mendore, kuzhina, lavanteria, zgjerimi i hapësirës teknike); ii) Ndërtimi i ambienteve të përshtatshme për pacientët kronikë të psikiatrisë gjatë vitit të parë të zbatimit; iii) Riintegrimi i poliklinikës në zonën spitalore (rreth 15-17 shërbime); iv) Organizimi i rrjedhës së logjikshme të punës; v) Përmirësimi i regjistrimit dhe menaxhimit.					
Asistenca teknike	PIU do të asistohet në rishikimin teknik të dizenjove arkitekturore dhe inxhinierike dhe shtjellimin e specifikimeve teknike të punëve dhe pajisjeve (duke përfshirë impiantin e djegies) nga e njëjta firmë e pavarur e huaj inxhinierike dhe arkitekture, si dhe gjatë dy fazave të para.					
Vendndodhja	Rrethi i Shkodrës					
Kostoja e përgjithshme e parashikuar e projektit	10 500 000 pa TVSH					
Analiza treguese e shpenzimeve (pa TVSH)	Zërat	(në EUR)	CEB	CEB-NTA	GoA	TOTAL
	Punimet		4 909 000		3 331 000	8 240 000
	Teknologjia mjekësore		0		1 000 000	1 000 000
	Ndërtimi i kapaciteteve të sistemit të regjistrimit		310 000		0	310 000
	Asistencë teknike, monitorimi		571 000	150 000		721 000
	Shpenzimet e PIU-ut		170 000	-	-	170 000
	Auditimi		40 000	-	-	40 000
	Totali		6 000 000	150 000	4 331 000	10 481 000
Plani i financimit	Huaja e CEB-it: 6 000 000 euro Dhurimi i CEB-it përmes NTA: 150 000 euro Republika e Shqipërisë: 4 331 000 euro					
Ecuria e punëve në momentin e aplikimit të	0%					

huasë	
Grafiku kohor i punimeve	2008-2010
Data e pritshme e përfundimit të projektit	31 dhjetor 2010
Data e mbylljes	30 qershor 2011

III

Kriteret e përshtatshmërisë (në zonën e ndërhyrjes)	Projekti përputhet me kriteret e përshtatshmërisë të parashikuara në Rez. 1495 (2006).
---	--

IV.

Parakushte	I) Në lidhje me menaxhimit e mbeturinave, gjatë fazës së tretë të projektit, Ministria e Shëndetësisë do të blejë dhe instalojë një impiant djegës që mbulon nevojat e spitalit në pajtim me master planin e rishikuar. Impianti djegës është pjesë e detyrimeve të PIA-s gjatë fazës së dytë të projektit. Energjia e prodhuar nëpërmjet djegies së mbeturinave do të futet në sistemin e ngrohjes së ambientit dhe të sistemit të përgatitjes së ujit të ngrohtë në spital. Para kështit të parë të huasë: i) specifikimet teknike të impiantit të djegies do të përcaktohen nga PIA dhe miratohen nga CEB-i; ii) PIA siguron financimin e nevojshëm për blerjen e impiantit të djegies dhe iii) do të zhvillojë tenderin në pajtim me axhendën e zbatimit të rënë dakord për projektin me CEB-in. II) Gjatë vitit të parë të zbatimit Ministria e Shëndetësisë do të ndërtojë njësitë e kujdesit rezidencial për pacientët psikiatrikë kronikë (Shtëpitë e Mimosave). Para kështit të parë të punëve në lidhje me ndërtesën ekzistuese të psikiatrisë, Ministria e Shëndetësisë do t'i transferojë pacientët e sëmurë mendorë te Shtëpitë Mimosave.
------------	---

V

Efektet sociale (në zonën e ndërhyrjes)	Spitali rajonal i Shkodrës është qendra më e rëndësishme shëndetësore për pacientët e brendshëm dhe të jashtëm në veriun e Republikës së Shqipërisë. Rehabilitimi i fazës së tretë do të përmirësojë mundësimin e kujdesit shëndetësor për banorët e rrethit të Shkodrës dhe të rrethinave, duke garantuar një sistem kujdesi shëndetësor të efektshëm dhe të qëndrueshëm. Menjëherë pas përfundimit të fazës së tretë, spitali do të zbatojë kriteret e reja të
---	--

	shërbimeve shëndetësore dhe do të përfshijë një bashkërendim të mirë ndërmjet shërbimeve të specializuara, një plan konstruksioni të përshtatshëm për pacientin dhe nevojat e tyre personale, një fleksibilitet të gjerë të ndryshimeve potenciale, standarde të përshtatshme të kujdesit, të gjitha këto në interesin e lartë të pacientëve të brendshëm dhe të jashtëm të qarkut të Shkodrës.
--	---

SHTOJCA 2A

LETËR SHOQËRUESE PER NJË HUA ME NORMË FIKSE (FORMATI)

F/P 1385 Add 4 (2007) transh

Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës

Letër shoqëruese

Për Marrëveshjen kuadër të huasë datë (data)

Ndërmjet

Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (këtu të quajtur “CEB”) dhe Këshillit të Ministrave që përfaqëson Republikën e Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave (këtu quhet Huamarrësi),

Kjo letër shoqëruese¹ dhe Marrëveshja kuadër e huasë përcaktojnë termat dhe kushtet e rëna dakord për (numër) transhe në lidhje me nenin (numër) të kësaj Marrëveshjeje kuadër të huasë.

Shuma e huasë	6 000 000 euro
Maturimi	Maturimi përfundimtar (numri) vjeçar me një periudhë pa pagesë (numër) vjeçare.
Norma fikse e interesit	(numër përqindje) (neto) në vit pas zbritjes subvencionit të normës së interesit nga llogaria përzgjedhëse e mirëbesimit
Pagesa e interesit	Gjysmëvjeçare/vjeçare të prapambetura
Fraksioni i numërimit të ditëve	30/360 e pandryshuar, Konventa e modifikuar e ditës pasuese të punës
Ditë punë	Sipas përcaktimit në Marrëveshjen kuadër të huasë
Data e disbursimit	(datë)
Udhëzimet e pagesës (Huamarrësi)	Numri i llogarisë (numër) i (emri i bankës dhe qytetit).SWIFT CODE: (shifër) nëpërmjet (emri i bankës dhe qytetit përkatës) SWIFT CODE: (shifër)
Udhëzimet e pagesës (CEB)	Sipas nenit 3.4 të Marrëveshjes kuadër të huasë

Pagesat për interesin dhe shumën principale do të bëhen në pajtm me grafikun e shlyerjeve të bashkëngjitur. Ndërsa interesi do të paguhet për herë të parë më (datë), shuma principale do të shlyhet për herë të parë më (datë).

Të gjitha pagesat bëhen në llogarinë e CEB-it sipas udhëzimeve për pagesat (CEB) të përshkruara më sipër.

Këto dispozita i nënshtrohen marrëveshjes së “Konventës së modifikuar të ditës pasuese të punës”, përkufizimi i së cilës gjendet në Marrëveshjen kuadër të huasë, të nënshkruar ndërmjet CEB-it dhe Huamarrësit më (datë).

(Qyteti, datë)

(Qyteti, datë)

Për Këshillin e Europës
Banka për Zhvillim

Për (Emri i Huamarrësit)

SHTOJCA 2B

LETËR SHOQËRUESE PËR NJË HUA ME NORMË VARIABËL (FORMATI)

F/P 1385 Add 4 (2007) Transh

Banka Për Zhvillim e Këshillit të Europës

Letër shoqëruese

Për Marrëveshjen kuadër të huasë datë (data)

Ndërmjet

Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës (këtu të quajtur “CEB”) dhe Këshillit të Ministrave që përfaqëson Republikën e Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave (këtu quhet Huamarrësi),

Kjo letër shoqëruese dhe Marrëveshja kuadër e huasë përcaktojnë termat dhe kushtet e rëna dakord për (numër) transhe në lidhje me nenin (numër) të kësaj Marrëveshjeje kuadër të huasë.

Shuma e huasë

(monedha dhe shuma)

Maturimi

Maturimi përfundimtar (numri)-vjeçar me një periudhë pa pagesë (numër) vjeçare.

EURIBOR (or LIBOR)

(fut përkufizimin e EURIBOR-it ose LIB OR-it)

Norma variabël e interesit

EURIBOR ose LIBOR 3 ose 6 muaj plus ose minus (numër) pikë bazë (neto) në vit pas zbritjes së subvencionit të normës së interesit nga llogaria përzgjedhëse e mirëbesimit (Telerate (referenca) or Reuters (referenca))

Pagesa e interesit

Semestrare/gjysmëvjeçare të prapambetura

Fraksioni i numërimit të ditëve

tashmë/360, Konventa e modifikuar e ditës pasuese të punës

Ditë punë

Sipas përcaktimit në Marrëveshjen kuadër të huasë

Data e disbursimit

(datë)

Udhëzimet e pagesës (Huamarrësi)

Numri i llogarisë (numër) i (emri i bankës dhe qytetit) SWIFT CODE: (shifër) nëpërmjet (emri i bankës dhe qytetit përkatës) SWIFT CODE: (shifër)

Udhëzimet e pagesës (CEB)

Sipas nenit 3.4 të Marrëveshjes kuadër të huasë

(Vendos sipas rastit)

{Teksti i normës bazë të LIBOR-it dhe strukturës amortizuese të huasë

Norma e interesit do të llogaritet për secilën periudhë (numër) mujore, duke filluar nga data e disbursimit. Interesi do të caktohet dy ditë punë në Londër para çdo periudhe të re interesi. CEB-i do të informojë Huamarrësin në lidhje me interesin e pagueshëm çdo (numër) muaj. Pagesa e interesit do të kryhet në (dita, muaji⁴) çdo vit, dhe per herë të parë më (datë).(rendit datat e shlyerjes dhe shumën kryesore për t’u paguar në secilën datë).}

{Teksti i normës bazë të LIBOR-it

⁴ Përmend 4 data për pagesat 3-mujore dhe 2 data për pagesat 6-mujore

Norma e interesit do të llogaritet për secilën periudhë (numër) mujore, duke filluar nga data e disbursimit. Interesi do të caktohet dy ditë punë para çdo periudhe të re interesi. CEB-i do të informojë Huamarrësin në lidhje me interesin e pagueshëm çdo (numër) muaj. Pagesa e interesit do të kryhet në (dita, muaji⁵) çdo vit, dhe për herë të parë më (datë). Shuma principale do të shlyhet në një shumë totale më (datë)}.

{Teksti i normës bazë të LIBOR-it dhe strukturës amortizuese të huasë

Norma e interesit do të llogaritet për secilën periudhë (numër) mujore, duke filluar nga data e disbursimit. Interesi do të caktohet dy ditë punë para çdo periudhe të re interesi. CEB-i do të informojë Huamarrësin në lidhje me interesin e pagueshëm çdo (numër) muaj. Pagesa e interesit do të kryhet në (dita, muaji 6) çdo vit, dhe për herë të parë më (datë). (rendit datat e shlyerjes dhe shumën kryesore për t'u paguar në secilën datë)}

{Teksti i normës hazë të LIBOR-it dhe struktura e përmbledhur

Norma e interesit do të llogaritet për secilën periudhë (numër) mujore, duke filluar nga data e disbursimit. Interesi do të caktohet dy ditë punë para çdo periudhë të re interesi. CEB-i do të informojë Huamarrësin në lidhje me interesin e pagueshëm çdo (numër) muaj. Pagesa e interesit do të kryhet në (dita, muaji⁷) çdo vit, dhe për herë të parë më (datë). Shuma principale do të shlyhet në një shumë totale më (datë)}.

Të gjitha pagesat do të bëhen në llogarinë e CEB-it në pajtim me udhëzimet e pagesave (CEB) të përshkruara më sipër.

Këto dispozita i nënshtrohen marrëveshjes “Konventa e modifikuar e ditës pasuese të punës”, përkufizimi i së cilës jepet në Marrëveshjen kuadër të huasë, të nënshkruar ndërmjet CEB-it dhe Huamarrësit më (datë).

(Qyteti, datë)
Për Këshillin e Europës
Banka për Zhvillim

(Qyteti, datë)
Për (Emri i Huamarrësit)

SHTOJCA 3 PARIMET E CEB-IT PËR MENAXHIMIN E MJEDISIT

Qëllimi i parimeve për analizën e aspekteve mjedisore është paraqitur më poshtë:

1. Sigurimi që projektet e financuara nga Banka i janë nënshtruar një kontrolli paraprak mjedisor (vlerësimi paraprak) dhe që aspektet e tyre mjedisore të merren parasysh:

2. Mënjanimi i risqeve mjedisore dhe procedurave gjyqësore që mund të rrezikojnë zbatimin dhe funksionimin e një projekti.

3. Sigurimi që shpenzimet në lidhje me masat përkatëse mbrojtëse të mjedisit të vlerësohen dhe të integrohen në koston totale të projektit.

Huamarrësi duhet të japë të gjithë informacionin e nevojshëm për vlerësimin mjedisor të projektit.

⁵ Përmend 4 data për pagesat 3-mujore dhe 2 data për pagesat 6-mujore

⁶ Përmend 4 data për pagesat 3-mujore dhe 2 data për pagesat 6-mujore

⁷ Përmend 4 data për pagesat 3-mujore dhe 2 data për pagesat 6-mujore

Projektet e zbatuara në një shtet anëtar ose shtet aderues të Bashkimit Europian ose në një vend që i përket hapësirës ekonomike europiane (EEC) duhet të jetë në pajtim me rregullat europiane të mjedisit, parimet kryesore të të cilëve janë:

- parimi i kujdesit paraprak, parimi i parandalimit, parimi ku prioritet i jepet trajtimin të problemeve mjedisore në burim, dhe parimi “ndotësi pagan”;
- direktivat europiane në lidhje me studimet e impaktit mjedisor (EIS);
- direktivat europiane në lidhje me prodhimin industrial, menaxhimin e ujit dhe mbeturinave, ndotjen e tokës dhe ajrit dhe mbrojtjen e natyrës.

Për më tepër, projektet duhet të respektojnë të gjitha konventat dhe marrëveshjet përkatëse ndërkombëtare.

Për projektet e zbatuara në një shtet tjetër anëtar të CEB-it, duhet të zbatohen të njëjtat parime, në pajtim me përputhshmërinë e tyre me kushtet dhe ligjet e brendshme.

Dispozitat për analizën e aspekteve mjedisore, të zbatueshme për të gjithë projektet, janë si më poshtë:

A. Impakti mjedisor

- Çdo projekt duhet t’i nënshtrohet një kontrolli paraprak për ndonjë dëm potencial që ai mund t’i shkaktojë mjedisit.

- Kjo analizë duhet të bëjë të mundur klasifikimin e projektit në pajtim me kriteret përkatëse sipas përcaktimit të direktivës 85/337/CEE në lidhje me vlerësimin e impaktit mjedisor të projekteve të caktuara publike dhe private.

- Një studim i impaktit mjedisor duhet të kryhet nga një organ i pavarur në rastin e projekteve, zbatimi i të cilave dhe/ose funksionimi kanë një potencial të rëndësishëm për të dëmtuar mjedisin.

B. Rreziqet mjedisore

- Çdo projekt duhet t’i nënshtrohet një kontrolli paraprak për çdo rrezik mjedisor që mund të rrezikojë zbatimin e tij dhe/ose funksionimin e saktë.

- Disa shembuj të shumtë të projekteve të rrezikshme janë ato që zbatohen në lidhje me:

- sipërfaqet e mëparshme të mbetjeve industriale (rreziqet e tokës dhe ujërave nëntokësorë të kontaminuara;

- kantieret pranë ndërtimeve të rrezikshme;

- zonat që mund të përmyten;

- zonat sizmike (rreziqet e tërmetejeve, rrëshqitjeve të tokës, etj).

- Për çdo projekt që mund të ekspozohet ndaj rreziqeve thelbësore mjedisore, duhet të kryhet një diagnozë mjedisore (DM).

- DM-ja duhet të përfshijë një analizë të masave të marra për të kaluar rreziqet mjedisore të shkaktuara.

SHTOJCA 4

PROCEDURAT E PROKURIMIT SIPAS KUFIJVE TE FONDIT LIMIT

Kategoria	Vlera e kontratës (në mijë EURO)	Metoda e prokurimit
Punimet	Mbi 5,150 (fondi limit i BE-së*)	ICB (tender konkurrues ndërkombëtar)
	Ndërmjet 75 dhe fondit limit të BE-së	NCB (tender konkurrues kombëtar)
	Nën 75	Blerje me 3 oferta me shkrim
Mallrat & shërbimet	Mbi 206 (fondi limit i BE-së)	ICB
	Ndërmjet 75 dhe fondit limit të BE-së	NCB
	Nën 75	

*Përditësuar sipas rregulloreve të BE-së

SHTOJCA 5
PERFORMANCA E PROJEKTIT

Vendi: SHQIPËRIA

Data

PROJEKTI: F/P 1385 Add.4(2007) - Spitali Shkodër - Faza e 3-të

Treguesi	Njësia	Gjendja përpara financimit të projektit	Objekti i projektit (nëse është i disponueshëm)	Rezultatet e Projektit	Komente
Stafi i punësuar në total dhe sipas shërbimeve	Numri total dhe ndarja sipas shërbimeve				
Pacientët e shtruar	Numri në vit				
Konsultat e ambulatorëve	Numri në vit				
Shtretërit	Numri total prej të cilëve:				
	-Numri i shtretërve akutë				
	-Numri i shtretërve për qëndrim afatgjatë				
Norma e zënies së shtratis	%				
Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit	Numër ditësh				
Skanerë për tomografi të kompjuterizuar	Numri i njësive				
	Numri i praktikave në muaj				
Imazhi i rezonancës magnetike	Numri i njësive				
	Numri i praktikave në muaj				
Pajisje të radioterapisë	Numri i njësive				
	Numri i praktikave në muaj				
Mamografë	Numri i njësive				
	Numri i praktikave në muaj				
Ndërhyrje kirurgjikale	Ndërhyrje kirurgjikale të vogla				
	Ndërhyrje kirurgjilale të mëdha (specifikoni llojet e praktikave më të zakonshme)				
Transplantet	Numri në vit				
Lista e pritjes	Numri mesatar i pacientëve për çdo specialitet				
	Kohëzgjatja mesatare në muaj				
Analiza financiare	Shpeshtësia e transferimeve prej Buxhetit të Shtetit				
	Përqindja e këtyre transferimeve në raport				

	me të ardhurat totale vjetore të spitalit				
	Politika e spitalit për pagesën e furnitorëve				
	Kapitali qarkullues si përqindje ndaj të ardhurave vjetore të Spitalit (mjete qarkulluese /detyrimeve qarkulluese)				
	Mbeturina të prodhuara në muaj nga të cilat:				
Trajtimi i mbeturinave të rrezikshme	-Në ton të përpunuar në vend				
	-Në ton të përpunuar në jashtë				
	Shpjegoni procedurën e trajtimit të përdorur				

- ☐ Për t'u mbushur me përfundimin e projektit
- ☐ Për t'u mbushur në fillim të programit dhe pas financimit të projektit

VENDIM
Nr.219, datë 9.10.2008

PËR ZGJEDHJEN E INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM TË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE

Në mbështetje të nenit 11 pika 2 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", të ndryshuar dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Adriatik Llalla zgjidhet në detyrën e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.220, datë 9.10.2008

PËR MOSMIRATIMIN E DY ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË KONKURRENCËS

Në mbështetje të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 21 të ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar dhe të neneve 55 pika 1 e 111 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në propozimin e Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Të mos miratojë propozimin e Presidentit të Republikës, sipas dekretit nr.5769, datë 23.6.2008, për zgjedhjen e zotit Burhan Malevi në detyrën e anëtarit të Komisionit të Konkurrencës.
- II. Të mos miratojë propozimin e Presidentit të Republikës, sipas dekretit nr.5789, datë 30.6.2008, për zgjedhjen e zotit Engjëll Skreli në detyrën e anëtarit të Komisionit të Konkurrencës.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

DEKRET
Nr.5914, datë 13.10.2008

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, të Kushtetutës, të nenit 20 dhe të nenit 9 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm

DEKRETOJ:

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- 1.Ajet Sadri Behlulaj
- 2.Amidi Dear Dauti
- 3.Xheneta Hasan Beqoviq
- 4.Saranda Qazim Dervishi (Berisha)
- 5.Ilirjanë Nuredin Basha (Loxha)
- 6.Giuliana Lizet Rafael Oyola Antunez (de Vocaj)
- 7.Daniel Otto Gachnang
- 8.Suzana Daniel Gachnang
- 9.Dorothea Daniel Gachnang
- 10.Evelyn Marianne Bruno Gachnang

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 23.10.2008
Doli nga shtypi më 23.10.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 48 lekë